FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 147

Tiranë – E premte, 1 nëntor 2019

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 30.10.2019	Për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare.....	12115
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 696, datë 30.10.2019	Për përcaktimin e kufijve territorialë, hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre.....	12115
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 30.10.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 319, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për reformën në administratën publike 2015–2020", të ndryshuar.....	12127
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 698, datë 30.10.2019	Për hapjen e misionit të posaçëm të Republikës së Shqipërisë në Kiev, Ukrainë.....	12139
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 700, datë 30.10.2019	Për disa shtesa në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagesë të qirasë së disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit 'Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit–Rruga e Kavajës'", të ndryshuar.....	12139
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 30.10.2019	Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Rozafa" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore "Sektori Autopark, ish-Parku i Minierës së Hekur-Nikelit, Përrenjas", me numër pasurie 4/240, zona kadastrale 2924, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë.....	12140
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 702, datë 30.10.2019	Për shfuqizimin e vendimit nr. 564, datë 29.9.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për dhurimin UNESCO-s të ikonës 'Ngjallja e Llazarit', në kuadër të 60-Vjetorit të Anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë".....	12146

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 703, datë 30.10.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me nr. 316, zona kadastrale 2281, Bashkia Cërrik.....	12146
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 705, datë 30.10.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 19, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, qendra e qytetit Roskovec'"	12151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 31.10.2019	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.....	12154
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7, datë 22.10.2019	Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të menaxhimit të trafikut të komunikimeve, si dhe mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve.....	12154
Vendim i Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave nr. 3, datë 25.10.2019	Për deklasifikimin plotësisht të informacioneve (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror".....	12155

VENDIM
Nr. 695, datë 30.10.2019

PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR ADMINISTRIMIN E UJËRAVE NDËRKUFITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "b", të pikës 2, të nenit 8, dhe të pikës 2, të nenit 22, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përbërja e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare (në vijim, Komisioni) është, si më poshtë vijon:

- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, kryetar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për mjedisin, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimet, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për energjinë, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për peshkimin, ujitjen dhe kullimin, anëtar;
- zëvendësministër i ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen, anëtar.

2. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore ka rolin e sekretariatit teknik të Komisionit dhe kryen këto detyra:

a) organizon mbledhjet e Komisionit dhe njofton anëtarët;

b) planifikon dhe harton projektaktet, sipas tematikave përkatëse;

c) realizon çdo detyrë tjetër që i ngarkon kryetari i Komisionit;

ç) raporton periodikisht pranë Kryeministrit për veprimtarinë e Komisionit.

3. Komisioni ngarkohet për administrimin e ujërave ndërkufitare, administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në marrëveshjet ndërkombëtare, konventat dhe protokollet e nënshkruara nga Republika e Shqipërisë.

4. Komisioni ka të drejtë të krijojë nënkomisione me ekspertë të fushave përkatëse për probleme dhe çështje specifike.

5. Titullarët e institucioneve përgjegjëse të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë Komision.

6. Vendimi nr. 177, datë 26.3.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë dhe detyrat e Komisionit të Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare", i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Ngarkohen Komisioni i Posaçëm për Administrimin e Ujërave Ndërkufitare, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe institucionet e përmendura në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 696, datë 30.10.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KUFIJVE TERRITORIALË, HIDROGRAFIKË TË BASENEVE UJORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TË QENDRËS E PËRBËRJES SË KËSHILLIT TË SECILIT PREJ TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "c" dhe "ç", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Territori i Republikës së Shqipërisë, në funksion të menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në shtatë basene ujore, si më poshtë vijon:

a) baseni ujor Drin-Bunë, me qendër në Shkodër;

b) baseni ujor Mat, me qendër në Lezhë;

c) baseni ujor Ishëm, me qendër në Durrës;

ç) baseni ujor Erzen, me qendër në Tiranë;

d) baseni ujor Shkumbin, me qendër në Elbasan;

dh) baseni ujor Seman, me qendër në Fier;

e) baseni ujor Vjosë, me qendër në Vlorë.

2. Përcaktimi i kufijve territorialë të baseneve ujore është sipas hartës hidrografike të shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Përcaktimi i kufijve hidrografikë të çdo baseni ujor është sipas hartave hidrografike të shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në çdo basen ujor funksionon Këshilli i Basenit Ujor, në vijim KBU-ja.

5. Kryetar i KBU-së do të jetë prefekti i qarkut ku ndodhet qendra e basenit ujor.

6. Funksionet e sekretariatit teknik të KBU-së ushtrohen nga zyra e administrimit të basenit ujor përkatës.

7. Numri i anëtarëve për çdo KBU është, si më poshtë vijon:

a) baseni ujor Drin-Bunë 21 anëtarë;
b) baseni ujor Mat 19 anëtarë;
c) baseni ujor Ishëm 15 anëtarë;
ç) baseni ujor Erzen 15 anëtarë;
d) baseni ujor Shkumbin 19 anëtarë;
dh) baseni ujor Seman 31 anëtarë;
e) baseni ujor Vjosë 25 anëtarë.

8. Përbërjet e KBU-ve janë, si më poshtë vijon:

8.1 KBU Drin-Bunë përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Shkodër (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:

- Malësi e Madhe një anëtar;
- Tropojë një anëtar;
- Shkodër një anëtar;
- Fushë-Arës një anëtar;
- Has një anëtar;
- Vau i Dejës një anëtar;
- Pukë një anëtar;
- Kukës një anëtar;
- Dibër një anëtar;
- Lezhë një anëtar;
- Bulqizë një anëtar;
- Pogradec një anëtar.

c) drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:

-mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
-furnizimin me ujë një anëtar;
-hidroenergji dhe industri dy anëtarë.

8.2 KBU Mat përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Lezhë (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:

- Fushë-Arës një anëtar;
- Pukë një anëtar;
- Mirditë një anëtar;
- Lezhë një anëtar;
- Kurbin një anëtar;
- Krujë një anëtar;
- Mat një anëtar;
- Klos një anëtar;
- Bulqizë një anëtar.

c) drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar.

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë dy anëtarë;
- hidroenergji dhe industri dy anëtarë.

8.3 KBU Ishëm përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Durrës (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:

- Durrës një anëtar;
- Tiranë një anëtar;
- Krujë një anëtar;
- Vorë një anëtar;
- Kamzë një anëtar;

c) drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;

- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar.

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:
- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë dy anëtarë;
- ujitjen një anëtar;
- hidroenergji dhe industri një anëtar.

8.4 KBU Erzen përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Tiranë (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashki, emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:
- Tiranë një anëtar;
- Vorë një anëtar;
- Durrës një anëtar;
- Kavajë një anëtar;
- Shijak një anëtar;
- Rrogozhinë një anëtar.

c) drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e zonave të mbrojtura një anëtar;
- Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar.

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:
- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- hidroenergji dhe industri dy anëtarë.

8.5 KBU Shkumbin përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Elbasan (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:
- Librazhd një anëtar;
- Përrenjas një anëtar;
- Pogradec një anëtar;
- Elbasan një anëtar;
- Kavajë një anëtar;
- Peqin një anëtar;
- Rrogozhinë një anëtar;
- Lushnjë një anëtar;
- Divjakë një anëtar;
- Cërrik një anëtar;
- Belsh një anëtar.

c) drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e zonave të mbrojtura një anëtar;
- drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:
- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- hidroenergji dhe industri një anëtar.

8.6 KBU Seman përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Fier (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashkitë, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:
- Divjakë një anëtar;
- Lushnjë një anëtar;
- Belsh një anëtar;
- Cërrik një anëtar;
- Gramsh një anëtar;
- Kuçovë një anëtar;
- Ura Vajgurore një anëtar;
- Roskovec një anëtar;
- Patos një anëtar;
- Fier një anëtar;
- Pustec një anëtar;
- Maliq një anëtar;
- Berat një anëtar;
- Korçë një anëtar;
- Devoll një anëtar;
- Skrapar një anëtar;
- Poliçan një anëtar;
- Kolonjë një anëtar;
- Elbasan një anëtar;
- Mallakastër një anëtar;
- Memaliaj një anëtar;
- Përmet një anëtar.

c) drejtues të institucioneve lokale nga:
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit dy anëtarë.

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:
- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- hidroenergji dhe industri një anëtar.

8.7 KBU Vjosë përbëhet nga:

a) prefekti i qarkut Vlorë (kryetar);

b) drejtues të nivelit të lartë në bashki, të emëruar nga kryetarët përkatës të bashkive,:

- Fier një anëtar;
- Vlorë një anëtar;
- Mallakastër një anëtar;
- Selenicë një anëtar;
- Memaliaj një anëtar;
- Këlcyrë një anëtar;
- Përmet një anëtar;
- Kolonjë një anëtar;
- Tepelenë një anëtar;
- Gjirokastër një anëtar;
- Libohovë një anëtar;
- Dropull një anëtar;
- Konispol një anëtar;
- Sarandë një anëtar;
- Finiq një anëtar;
- Delvinë një anëtar;
- Himarë një anëtar.

c) drejtues të institucioneve lokale, si më poshtë vijon:

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit një anëtar;
- Administrata e Zonave të Mbrojtura një anëtar;
- drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor një anëtar;
- Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit një anëtar.

ç) përfaqësues të grupeve të interesit për:

- mbrojtjen e burimeve ujore një anëtar;
- furnizimin me ujë një anëtar;
- hidroenergji dhe industri një anëtar.

9. Drejtuesit e institucioneve lokale dhe përfaqësuesit e grupeve të interesit emërohen si anëtarë të KBU-së me miratimin e kryetarit të KBU-së përkatëse.

10. Anëtarët e KBU-së shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore, por jo më shumë se gjashtë pagesa në vit.

11. Vendimi nr. 342, datë 4.5.2016, i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre", i ndryshuar, shfuqizohet.

12. Ngarkohen organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

HARTA E KUFIJVE HIDROGRAFIKË



SHTOJCA 2

HARTA E KUFIRIT TË BASENIT DRIN - BUNË




HARTA E KUFIRIT TË BASENIT MAT
AMBU
460000
500000
4640000
4560000
N
Shkalla 1:500,000
Legjenda
KUFIRI SHTETËROR
RRJETI HIDROGRAFIK
BASENI MAT
BASHKITË
KUFIJTË HIDROGRAFIK
FUSHE ARRES
BASENI DRIN - BUNE
PUKE
LEZHE
MIRDITE
BASENI MAT
DETI ADRIATIK
KURBIN
MAT
KRUJE
KLOS
BULQIZE
BASENI ISHEM
BASENI ERZEN
BASENI SHKUMBIN
BASHKITË QË BËJNË PJESË NË BASENIN MAT:
1. KRUJË
2. KLOS
3. BULQIZË
4. KURBIN
5. MAT
6. LEZHË
7. MIRDITË
8. PUKË
9. FUSHË ARRËS
MALI I ZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
0 5 10 20 30 40
Kilometers
Burimi i të dhënave: Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapesinor
Sistemi i referimit: KRGJSH


HARTA E KUFIRIT TË BASENIT ISHËM
AMBU
460000
500000
4640000
4560000
Shkalla 1:400,000
N
BASENI DRIN - BUNE
BASENI MAT
DETI ADRIATIK
KRUJE
BASENI ISHEM
DURRES
VORE
KAMEZ
TIRANE
BASENI ERZEN
BASENI SHKUMBIN
Legjenda
KUFIRI SHTETËROR
BASHKITË
RRJETI HIDROGRAFIK
BASENI ISHËM
KUFIJTË HIDROGRAFIK
BASHKITË QË BËJNË PJESË NË BASENIN ISHËM:
1. KAMËZ
2. VORË
3. TIRANË
4. DURRËS
5. KRUJË
MALI I ZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
0 3.75 7.5 15 22.5 30
Kilometers
Burimi i të dhënave: Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor
Sistemi i referimit: KRGJSH


HARTA E KUFIRIT TË BASENIT ERZEN
AMBU
450000
500000
4600000
4540000
BASENI DRIN - BUNE
BASENI MAT
BASENI ISHEM
BASENI ERZEN
BASENI SHKUMBIN
BASENI SEMAN
BASENI VJOSE
DURRES
VORE
SHIJAK
TIRANE
KAVAJE
RROGOZHINE
DETI ADRIATIK
N
Shkalla 1:500,000
Legjenda
KUFIRI SHTETËROR
BASHKTË
RRJETI HIDROGRAFIK
BASENI ERZENIT
KUFIJTË HIDROGRAFIK
BASHKITËËQE BËJNË PJESË NË BASENIN ERZEN:
1. RROGOZHINË
2. KAVAJË
3. VORË
4. TIRANË
5. DURRËS
MALI I ZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
0 5 10 20 30 40
Kilometers
Burimi i të dhënave: Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor
Sistemi i referimit: KRGJSH


HARTA E KUFIRIT TË BASENIT SHKUMBIN
AMBU
480000
540000
4640000
4560000
4480000
BASENI DRIN - BUNE
KOSOVA
MAQEDONIA
BASENI MAT
BASENI DRIN - BUNE
BASENI ISHEM
BASENI ERZEN
BASENI SHKUMBIN
BASENI SEMAN
BASENI VJOSE
DETI ADRIATIK
KAVAJE
RROGOZHINE
PEQIN
ELBASAN
LIBRAZHD
PRRENJAS
DIVJAKE
LUSHNJE
BELSH
CERRIK
POGRADEC
N
Shkalla 1:750,000
Legjenda
KUFIRI SHTETËROR
BASHKITË
RRJETI HIDROGRAFIK
BASENI SHKUMBIN
KUFIJTË HIDROGRAFIK
BASHKITË QË BËJNE PJESË NË BASENIN SHKUMBIN:
1. BELSH
2. CËRRIK
3. LUSHNJE
4. DIVJAKE
5. POGRADEC
6. PEQIN
7. RROGOZHINE
8. PRRENJAS
9. KAVAJË
10. ELBASAN
11. LIBRAZHD
MALI I ZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
0 5 10 20 30 40
Kilometers
Burimi i të dhënave: Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapësinor
Sistemi i referimit: KRGJSH


HARTA E KUFIRIT TË BASENIT SEMAN
AMBU
480000
540000
4560000
4480000
4400000
Shkalla 1:1,100,000
N
Legjenda
KUFIRI SHTETËROR
BASHKITË
RRJETI HIDROGRAFIK
BASENI SEMAN
KUFIJTË HIDROGRAFIK
BASHKITË QË BËJNË PJESË NË BASENIN SEMAN:
1. PËRMET
2. KOLONJË
3. MEMALIAJ
4. MALLAKASTER
5. KORÇË
6. POLICAN
7. SKRAPAR
8. SKRAPAR
9. PATOS
10. DEVOLL
11. BERAT
12. ROSKOVEC
13. MALIQ
14. URA VAJGURORE
15. FIER
16. PUSTEC
17. GRAMSH
18. BELSH
19. CËRRIK
20. LUSHNJE
21. DIVJAKË
22. ELBASAN
BASENI MAT
BASENI DRIN - BUNE
BASENI ISHEM
BASENI ERZEN
BASENI SHKUMBIN
BASENI SEMAN
BASENI VJOSE
MAQEDONIA
GREQIA
DETI ADRIATIK
DETI JON
ELBASAN
LUSHNJE
CERRIK
DIVJAKE
BELSH
KUCOVE
GRAMSH
PUSTEC
URA VAJGURORE
MALIQ
FIER
ROSKOVEC
PATOS
BERAT
KORCE
DEVOLL
MALLAKASTER
POLICAN
SKRAPAR
MEMALIAJ
KOLONJE
PERMET
MALIZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
0 10 20 40 60 80
Kilometers
Burimi i të dhënave: Autoriteti Shtetëror i Informacionit Gjeohapesinor
Sistemi i referimit: KRGJSH


HARTA E KUFIRIT TË BASENIT VJOSË
AMBU
480000
540000
4560000
4480000
4400000
BASENI ISHEM
BASENI MAT
BASENI DRIN - BUNE
BASENI ERZEN
MAQEDONIA
BASENI SHKUMBIN
BASENI SEMAN
DETI ADRIATIK
DETI JON
FIER
VLORE
MALLAKASTER
SELENICE
MEMALIAJ
KELCYRE
TEPELENE
KOLONJE
PERMET
BASENI VJOSË
HIMARE
GJIROKASTER
LIBOHOVE
DELVINE
DROPULL
FINIQ
SARANDE
KONISPOL
GREQIA
GREQIA
N
Shkalla 1:950,000
Legjenda
KUFIRI SHTETËROR
BASHKITË
RRJETI HIDROGRAFIK
BASENI VJOSË
KUFIJTË HIDROGRAFIK
BASHKITË QË BËJNË PJESË NË BASENIN VJOSË:
1. KONISPOL
2. SARANDË
3. FINIQ
4. DELVINE
5. DROPULL
6. GJIROKASTËR
7. LIBOHOVË
8. HIMARË
9. TEPELENË
10. PËRMET
11. KOLONJË
12. KËLCYRE
13. MEMALIAJ
14. SELENICË
15.MALLAKASTËR
16. VLORË
17. FIER
MALLIZI
KOSOVA
MAQEDONIA
GREQIA
0 10 20 40 60 80
Kilometers
Burimi i të dhënave: Autoriteti Shtetror i Informacionit Gjeohapësinor
Sistemi i referimit: KRGJSH

VENDIM
Nr. 697, datë 30.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 319, DATË 15.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR REFORMËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE 2015–2020", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 319, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015–2022".

2. Në dokumentin bashkëlidhur vendimit bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Ndarja: "Vlerësimi i ri i kostos për planin e ri të aktiviteteve të strategjisë për periudhën 2018–2020", ndryshohet me përmbajtjen sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Lidhja 1/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me emërtimin "Plani i aktiviteteve dhe treguesit për periudhën 2018–2022", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja 2/1 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe me emërtimin "Vlerësimi i detajuar i kostos për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike për planin e veprimit për periudhën 2018–2022", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kudo në vendim dhe në tekstin bashkëlidhur:

a) Fjalët: "... Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015–2020 ..." zëvendësohen me "... Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015–2022 ...";

b) Fjalët: "... Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015–2020 ...", zëvendësohen me "... Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015–2022 ...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja 1/1

Plani i aktiviteteve dhe Treguesit për periudhën 2018 – 2022

Nr. Aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Nr. i nën-aktivitetit	Detajimi i nën-aktivitetit	Institucioni raportues/ përgjegjës	Institucione të tjera përgjegjëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Mënyra e matjes së realizimit
Objektivi 1: Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmirësuara për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete								
Aktiviteti 1.1	***Përmirësimi i procesit dhe cilësisë së hartimit dhe monitorimit të dokumenteve strategjike***	Nën- aktiviteti 1.1.1	Hartimi i metodologjisë për përgatitjen e dokumenteve strategjike (strategji, programe, plane veprimi, dokumente politikash etj).	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	TM III 2019	TM IV 2020	Metodologjia e përgatitur
		Nën- aktiviteti 1.1.2	Hartimi i paketës ligjore për funksionalitetin e sistemit IPSIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/ Grupi i Punës	TM I 2020	TM IV 2022	Paketa e plotë rregullatore e hartuar dhe miratuar (1 VKM për IPSIS si e-register; 1 VKM për funksionalitetin e IPSIS; 2 Urdhra të KM për modulet e IPSIS në lidhje me përgatitjen e strategjive, planeve të veprimit, raporteve e monitorimit, programeve, IPS kalendar, Ndryshimet në Udhëzimet e përmbajtjes të PBA)
		Nën- aktiviteti 1.1.3	Funksionimi i plotë i Sistemit të Informacionit për Sistemin e Planifikimit të Integruar - IPSIS ("go live" për IPSIS në 2019)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit/ Grupi i Punës	TM I 2020	TM IV 2020	Raportet e monitorimit për performancën e sistemit
		Nën- aktiviteti 1.1.4	Përmirësimi i kapaciteteve të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & ministrive të linjës në drejtim të monitorimit të politikave/strategjive/planeve të veprimit/programeve zhvillimore, në përputhje me metodologjitë e IPSIS & AFMIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/ Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Ministritë e linjës	TM III 2019	TM IV 2019	Nr. i stafeve për politikat në ministritë e linjës i trajnuar
		Nën- aktiviteti 1.1.5	Hartimi i manualit të trajnimit për stafet e ministrive të linjës në lidhje me monitorimin e kuadrit strategjik (strategji/programe/dokumente politikash) dhe trajnimi i stafit	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/ Ministritë e linjës	TM III 2019	TM IV 2019	Manuali i Trajnimit për monitorimin e kuadrit strategjik Nr. i punonjëve të trajnuar
		Nën- aktiviteti 1.1.6	Ngritja e kapaciteteve dhe përgatitja e manualit të trajnimit për përdorimin e sistemit IPSIS nga përdoruesit në niveleve të ndryshme	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/Ministritë e Linjës	TM IV 2019	TM IV 2020	Manuali i Trajnimit për përdorimin e sistemit IPSIS Nr. i punonjëve të trajnuar
		Nën- aktiviteti 1.1.7	Dizenjimi dhe përshtatja e platformës IPSIS për përdorim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore. Pilotimi i implementimit të sistemit në 5 bashki.	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Njësitë e Qeverisjes Vendore	TM IV 2020	TM IV 2022	Nr. i bashkive që implementojnë sistemin IPSIS
		Nën- aktiviteti 1.1.8	Përgatitja dhe përditësimi i formateve standarde për funksionimin e grupeve të punës për programin "Administrata që duam"	Departamenti i Administratës Publike		TM I 2019	TM IV 2021	Formatet standarde të hartuara/updatuara
Aktiviteti 1.2	***Përmirësimi i instrumenteve për politikat e zhvillimit dhe mirëqeverisjes në nivel qendror dhe në nivel sektori***	Nën- aktiviteti 1.2.1	Përgatitja e një Udhëzimfytyre për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (faze paraprake si gjesë e procesit të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare pas-2020)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Grupi i Punës	TM III 2018	TM III 2020	Udhërrëfyesi i përgatitur dhe miratuar
		Nën- aktiviteti 1.2.2	Rishikimi i bazës ligjore dhe kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG-ve dhe/ose SWG për të adresuar dhënë në strukturat e qeverisë dhe ndryshimin e funksioneve	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	TM II 2018	TM IV 2018	Dokumente të rishikuara
		Nën- aktiviteti 1.2.3	Përgatitja dhe përditësimi periodik i formateve standarde (tool kit) për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen & udhëzime operacionale/Progresi IPMG (rishikimi i kuadrit rregullator për funksionimin e IPMG për Mirëqeverisjen)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme/ Ministria e Financave dhe Ekonomisë & ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2020	Toolkit i përgatitur
		Nën- aktiviteti 1.2.4	Funksionimi sistematik i Grupit Tematik për Politikëbërjen si dhe ngritja e mjetit për politikëbërjen me njësitë e politikave në ministritë e linjës	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme/ Ministria e Financave dhe Ekonomisë & ministritë e linjës	TM III 2018	TM I 2019	Nr. i mbledhjeve të G.T për Politikëbërjen Nr. i mbledhjeve për rrjetin e politikëbërjes me ML-të
		Nën- aktiviteti 1.2.5	Finalizimi i kalendarit të integruar të veprimtarisë së GMIP-ve dhe KDS-ve	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM I 2019	TM IV 2022	Kalendari i integruar
		Nën- aktiviteti 1.2.6	Finalizimi i Raport Progresit (6 mujor dhe Vjetor) të veprimtarisë së GMIP/KDS si dhe Grupeve Tematike në përbërje	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM II 2019	TM IV 2022	Raport Progreset gjashtë mujore dhe vjetore
		Nën- aktiviteti 1.2.7	Finalizimi i Raport Progresit të dedikuar (6 mujor dhe Vjetor) për rolin e GMIP/KDS si Komitete Sektoriale të Monitorimit të IPA-s	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Sekretariati i Përgjithshëm	TM II 2019	TM IV 2022	Raport Progreset gjashtë mujore dhe vjetore
		Nën- aktiviteti 1.2.8	Finalizimi i Paketës së udhëzimeve, guidave dhe notave të pozicionit për funksionimin e GMIP/KDS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM I 2019	TM IV 2022	Paketa e finalizuar
		Nën- aktiviteti 1.2.9	Finalizimi i programit ndërsektorial për Mirëqeverisjen	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM IV 2020	TM IV 2022 e vijim	Programi sektorial për Mirëqeverisjen
		Nën- aktiviteti 1.2.10	Hartimi i paketës së Raport Progresit për Reformën e Administratës Publike në kuadër të PAR SG	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM IV 2020	TM IV 2022	Paketa e finalizuar
		Nën- aktiviteti 1.2.11	Hartimi i raportit të vlerësimit të politikave kombëtare dhe rajonale	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Grupi Tematik i Politikëbërjes	Ministritë e Linjës dhe OECD	TM IV 2019	TM IV 2020	Raporti i finalizuar
		Nën- aktiviteti 1.2.12	Hartimi i strategjisë për kuadrin mirë-regullator / better regulation multi-action annual plan dhe planit të veprimit	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Ministritë e Linjës	TM II 2020	TM I 2021	Strategjia dhe PV i hartuar
Objektivi 2: Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis								
Aktiviteti 2.1	***Përmirësimi i mekanizmave dhe instrumenteve të lidhura me konsultimin publik***	Nën- aktiviteti 2.1.1	Përgatitja e Udhëzimeve Operacionale për ministritë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrit të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM II 2018	TM IV 2018	Guida Operacionale e hartuar
		Nën- aktiviteti 2.1.2	Trajnim/Ngritja kapaciteteve për stafin përgjegjës në ministritë e linjës për përdorimin e e-platformës së konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit / Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2018	Stafi i trajnuar
		Nën- aktiviteti 2.1.3	Përgatitja dhe përditësimi periodik i manualit për konsultimin publik (për publikun dhe ekspertët) për të lehtësuar pjesëmarrjen në konsultimet publike përmes përdorimit të regjistrit të e-konsultimit	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM II 2018	TM IV 2020	Manuali i përdoruesve i hartuar
		Nën- aktiviteti 2.1.4	Publikimi në sistem i raporteve të konsoliduara që paraqesin nivelin e reflektimit të konsenteve të publikuar	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM II 2018	TM IV 2018	Funksionaliteti i platformës i përmirësuar
		Nën- aktiviteti 2.1.5	Monitorimi periodik i realizimit të procesit të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2020	Raportet e monitorimit të hartuara (raporti i parë i përgatitur në TM I 2019)
		Nën- aktiviteti 2.1.6	Hartimi periodik i Outlook report për procesin e konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM IV 2020	TM IV 2022	Outlook Report
		Nën- aktiviteti 2.1.7	Hartimi i dokumentit të analizës ligjore të kuadrit të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Agencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM I 2019	TM IV 2020	Dokumenti i analizës ligjorete kuadrit të konsultimit publik
		Nën- aktiviteti 2.1.8	Hartimi i dokumentit të kuadrit metodologjik për përmirësimin e procesit të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM III 2019	TM IV 2020	Dokumenti i kuadrit metodologjik për përmirësimin e procesit të konsultimit publike
		Nën- aktiviteti 2.1.9	Hartimi i metodologjisë sektoriale për njoftimin dhe konsultimin publik të akteve (projektligje/ projektvendime të dokumentave strategjikë)	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM I 2020	TM IV 2020	Metodologjia Sektoriale
		Nën- aktiviteti 2.1.10	Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve në kuadër të përmirësimit të procesit të konsultimit publik, përfshirë planifikimin, inicimin dhe raportimin e procesit.	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM IV 2019	TM IV 2022	Nr. i punonjëve të trajnuar
		Nën- aktiviteti 2.1.11	Hartimi i planit analitik vjetor të konsultimit publik	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes		TM II 2020	TM I 2022	Plani vjetor analitik
Aktiviteti 2.2	***Zbatimi i procedurës për kryerjen e vlerësimit të ndikimit rregullator (vlerësimi ex-ante) gjatë procesit të hartimit të politikave/legjislacionit, bazuar në të dhëna dhe dëshmi***	Nën- aktiviteti 2.2.1	Vendosja e rregullave që bëjnë të detyrueshëm zbatimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TMI 2018	TM II 2018	VKM 584 date 28.08.2003 me ndryshime e miratuar
		Nën- aktiviteti 2.2.2	Rishikimi i rregullave të zbatimit të vlerësimit të ndikimit, me qëllim përmirësimin e procesit të Vlerësimit të Ndikimit	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM III 2020	TM IV 2020	Rregulla të rishikuara
		Nën- aktiviteti 2.2.3	Përditësimi i Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit (RIA), në përputhje me nevojat dhe zhvillimet e mëtejshme të procesit	Njësia e Programimit të Aktëve Rregullatore	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	TM I 2020	TM II 2020	Metodologjia e përditësuar
		Nën- aktiviteti 2.2.4	Forcimi i kapaciteteve, në përmjet trajnimeve të ndryshme të nëpunësve (Rjeti RIA) në ministritë e linjës dhe Kryeministri, me qëllim përmirësimin e procesit të vlerësimit të ndikimit rregullator	Njësia e Programimit të Aktëve Rregullatore	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM I 2018	TM IV 2019	Numri i nëpunësve të trajnuar
		Nën- aktiviteti 2.2.5	Aplikimi i Vlerësimit të Ndikimit (RIA) për aktet ligjore të rëndësishme që hartohen nga ministritë e linjës	Njësia e Programimit të Aktëve Rregullatore	Ministritë e linjës	TM III 2018	TM IV 2018 30% e projekt-ligjeve shoqërohen me RIA	Nr. i projektligjeve të përgjedhura që i nënshtrohen RIA-s
		Nën- aktiviteti 2.2.6	Përcaktimi i kritereve të kontrollit të cilësisë së RIA-s	Njësia e Programimit të Aktëve Rregullatore	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	TM I 2019	TM II 2019	Kriteret e përcaktuara
Aktiviteti 2.3	***Rritja e transparencës në botimin e legjislacionit***	Nën- aktiviteti 2.3.1	Monitorimi i vazhdueshëm i botimit të akteve ligjore të konsoliduara, në faqet e internetit të institucionevе	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM I (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Raporte 6 mujore mbi gjetjet e monitorimit të publikimit të akteve
	Forcimi i masave për planifikimin e Programit të Përgjithshëm Analitik	Nën-aktiviteti 2.4.1	Përmirësimi i procesit të planifikimit të hartimit të akteve ligjore në përmjet përcaktimit të afateve dhe rregullave të përgjithshme të procesit të hartimit të PPAP	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë	Ministritë e Linjës	TM III (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Procedurat e reja të miratuara

Aktiviteti 2.4	***Të Projektaktet (PPAP), me synim harmonizimin me PHE dhe zvogëlimin e numrit të projektligjeve të paraqitura në Kuvend jashtë këtij programi***	Nën-aktiviteti 2.4.2	Dërgimi sistematik në Parlament i planit analitik të akteve brenda muajit dhjetor të çdo viti	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM IV (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Plani përcjellë Parlamentit
		Nën-aktiviteti 2.4.3	Monitorimi sistematik i zbatimit të Programit të Përgatitshëm Analitik të Projekteve	Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë		TM I (çdo vit)	TM IV (çdo vit)	Raportet 4-mujore të monitorimit të hartuara
Objektivi 3: Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjëanës dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi								
Aktiviteti 3.1	***Përmirësimi i mekanizmave për monitorimin e kuadrit strategjik dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020***	Nën-aktiviteti 3.1.1	Monitorimi sistematik i zbatimit të Planit Vjetor të hartimit të Dokumenteve Strategjike	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ Ministritë e Linjës	Ministritë e linjës	TM I 2018	TM IV 2020	(i) Plani Vjetor i Kuadrit Strategjik i hartuar; (ii) Raporti i Monitorimit i hartuar
		Nën-aktiviteti 3.1.2	Vendosja e një procesi sistematik për monitorimin e dokumenteve strategjike përmes moduleve IPSIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ Ministritë e Linjës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM I 2020	TM IV 2022	(i) Urdhri për monitorimin e kuadrit strategjik, si pjesë e paketës ligjore për funksionimin e IPSIS (ii) Nr. i dokumenteve strategjike që hartohen në përputhje me metodologjinë e re
		Nën-aktiviteti 3.1.3	Hartimi i raporteve të monitorimit në përputhje me standartet e sistemit IPSIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministritë e linjës	TM IV 2020	TM IV 2022	Raporte monitorimi
		Nën-aktiviteti 3.1.4	Përgatitja e Manualit të Trajnimit për stafet e ministrive të linjës në lidhje me monitorimin e kuadrit strategjik (strategji/programe/dokumente politikash) dhe trajnimi i stafit	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes/ Ministritë e Linjës	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM IV 2019	TM IV 2020	Manuali i përgatitur/ nr. i personave të trajnuar
		Nën-aktiviteti 3.1.5	Monitorimi i zbatimit të Planit të Ekzekutimit të Programit "Administrata që duam"	Departamenti i Administratës Publike		TM IV 2018	TM IV 2021	(i) Plani-vjetor i programit i hartuar; (ii) Raporti vjetor i monitorimit i hartuar
Objektivi 4: Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut								
Aktiviteti 4.1	***Rishikimi funksional dhe i organizimit të brendshëm në institucionet e administratës shtetërore***	Nën-aktiviteti 4.1.1	Pilotimi i metodologjisë së SIGMA-s për ristrukturimin në 3 sisteme ministrore (institucionet e varësisë)	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2019	(i) Pilotimi i përfunduar; (ii) Raportet e vlerësimit të hartuara
		Nën-aktiviteti 4.1.2	Vënia në zbatim e modelit të ri të organizimit për institucionet e varësisë në 3 sistemet e pilotuara	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2019	(i) Strukturat e reja të krijuara; (ii) VKM të miratuara
		Nën-aktiviteti 4.1.3	Përkufizimi i tipologjisë standarde të organizimit të institucioneve të varësisë dhe miratimi i saj	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM IV 2018	TM IV 2019	Modeli i tipologjisë i miratuar
Aktiviteti 4.2	***Mbështetje për funksionimin e HJQV-ve dhe forcim të kapaciteteve zbatuese***	Nën-aktiviteti 4.2.1	Publikimi i udhëzimeve për menaxhimin e burimeve njerëzore nëpërmjet politikat dhe praktikat në nivel lokal	Agencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Departamenti i Administratës Publike	TM I 2018	TM II 2018	Udhëzime të publikuara
		Nën-aktiviteti 4.2.2	Adoptimi i formateve standarde për përshkrimin e punës, procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të performancës bazuar në Toolkit për menaxhimin e burimeve njerëzore	Agencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Departamenti i Administratës Publike	TM I 2018	TM II 2018	Formatet standarde të hartuara
		Nën-aktiviteti 4.2.3	Zbatimi i procesit të arkivimit fizik të dokumentacionit në secilën bashki	Agencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	NJQV	TM III 2018	TM IV 2018	Numri i bashkive ku sistemi i arkivimit është funksional
		Nënaktiviteti 4.2.4	Rritja e kapaciteteve institucionale për përfshirjen dhe konsultimin e publikut	Agencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	NJQV/ Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2018	(i) Numri i zyrtarëve të trajnuar mbi qështjet e përfshirjes dhe konsultimit publik; (ii) Numri i bashkive që aplikojnë sistemin e matjes së performancës mbi përfshirjen dhe konsultimin e publikut në vendimmarrjen e qeverisjes vendore
Objektivi 5: Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike								
Aktiviteti 5.1	***Hapja e Qendrave të integruara për ofrimin e shërbimeve publike***	Nën-aktiviteti 5.1.1	Ngritja dhe funksionimi i së paku 11 Qendrave të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike në Tiranë dhe në rrethe	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	11 Qendra të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike në Tiranë dhe në rrethe, të ngritura dhe funksionale.
		Nën-aktiviteti 5.1.2	Ngritja dhe funksionimi i së paku 4 Njësive Lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike në zonat rurale	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	4 Njësi Lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike në zonat rurale.
Aktiviteti 5.2	***Ndarja e Administratës të Sporteleve të Shërbimit (front-office) për publikun nga syrtat përgjegjëse (back-office) të shërbimit në institucionet qendrore***	Nën-aktiviteti 5.2.1	Ndarja e sporteleve për 10 institucione qendrore	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2022	Numri i sporteleve të marra në administrim.
		Nën-aktiviteti 5.2.2	Shtimi i të paktën 60 sporteleve me standardë të përmirësuar për ofrimin e shërbimeve publike në të gjitha Qendrat e Integruara ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	Numri i sporteleve të shtuara në të gjitha Qendrat e Integruara ADISA.
		Nën-aktiviteti 5.2.3	Përshtatja e procedurave të reja të brendshme dhe manualeve të institucioneve sipas standardeve të reja të punës	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2022	Numri i rregulloreve dhe manualeve të miratuara.
Aktiviteti 5.3	***Zhvillimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike***	Nën-aktiviteti 5.3.1	Hartimi dhe miratimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM I 2019	Akti nënligjor i miratuar
		Nën-aktiviteti 5.3.2	Monitorimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike pranë qendrave të integruara dhe sporteleve të shërbimeve ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2019	TM IV 2022	(i)Raporte periodike për vlerësimin e cilësisë; (ii)Lista e rekomandimeve të nxjerra
		Nën-aktiviteti 5.3.3	Pilotimi i zbatimit të kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike pranë institucioneve të qeverisjes qendrore	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2019	TM IV 2022	(i)Raporte periodike për vlerësimin e cilësisë; (ii)Lista e rekomandimeve të nxjerra
3.1.2	Dokumenta strategjike të hartuara sipas modulevë të IPSIS përmes një procesi sistematik (i) Urdhri për monitorimin e kuadrit strategjik, si pjesë e paketës ligjore për funksionimin e IPSIS (ii) Nr. i dokumenteve strategjike që hartohen në përputhje me metodologjinë e re	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministria e Financave dhe Ekonomisë/ Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit	TM I 2020	TM IV 2022	7,150	-	-	7,150
3.1.3	Raporte të monitorimit të hartuara në përputhje me standartet e sistemit IPSIS	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Ministritë e Linjës	TM IV 2020	TM IV 2022	2,808	2,808	-	-
3.1.4	Manuali i Trajnimit për stafet e ministrive të linjës në lidhje me monitorimin e kuadrit strategjik (strategji/programe/dokumente politikash) dhe trajnimi i stafit i përgatitur	Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM IV 2019	TM IV 2020	26,390	-	-	26,390

3.1.5	Zbatimi i Planit të Ekzekutimit të Programit "Administrata që duam" i monitoruar (i) Plani vjetor i programit i hartuar; (ii) Raporti vjetor i monitorimit i hartuar	Departamenti i Administratës Publike		TM IV 2018	TM IV 2021	540	540	-	-
	Qëllimi i Politikës: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike								
4	**OBJEKTIVI SPECIFIK 4** Fuqizimi i strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut					**84,845**	**-**	**84,845**	**-**
4.1	**Rishikimi funksional dhe i organizimit të brendshëm në institucionet e administratës shtetërore i përfunduar**					**12,610**	**-**	**12,610**	**-**
4.1.1	Pilotimi i metodologjisë së SIGMA-s për ristrukturimin në 3 sisteme ministrore (institucionet e varësisë) i përfunduar dhe raportet e vlerësimit të hartuara	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2019	2,080	-	2,080	-
4.1.2	Modeli i ri i organizimit për institucionet e varësisë në 3 sistemet e pilotuara dhe të vëna në zbatim (i) Strukturat e reja të krijuara; (ii) VKM të miratuara	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM II 2018	TM IV 2019	kosto administrative			
4.1.3	Tipologjia standarde e organizimit të institucioneve të varësisë e përkufizuar dhe miratimi i saj	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e linjës	TM IV 2018	TM IV 2019	10,530	-	10,530	-
4.2	**Mbështetje për funksionimin e NJQV-ve dhe kapacitete zbatuese të forcuara**					**72,235**	**-**	**72,235**	**-**
4.2.1	Udhëzimet për menaxhimin e burimeve njerëzore mbi politikat dhe praktikat në nivel lokal të publikuara	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Departamenti i Administratës Publike	TM I 2018	TM II 2018	kosto administrative			
4.2.2	Formate standarde për përshkrimin e punës, procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të performancës bazuar në Toolkit për menaxhimin e burimeve njerëzore të hartuara	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Departamenti i Administratës Publike	TM I 2018	TM II 2018	kosto administrative			
4.2.3	Arkivimi fizik i dokumentacionit në secilën bashki funksional (Numri i bashkive ku sistemi i arkivimit është funksional)	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Njësitë e Qeverisjes Vendore	TM III 2018	TM IV 2018	64,764	-	64,764	-
4.2.4	Kapacitetet institucionale të rritura për përfshirjen dhe konsultimin e publikut (i) Numri i zyrtarëve të trajnuar mbi qështjet e përfshirjes dhe konsultimit publik; (ii) Numri i bashkive që aplikojnë sistemin e matjes së performacës mbi përfshirjen dhe konsultimin e publikut në vendimarrjen e qeverisjes vendore	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	Njësitë e Qeverisjes Vendore/Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2018	7,471	-	7,471	-
5	**OBJEKTIVI SPECIFIK 5** Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin e etikës në ofrimin e shërbimeve publike					**1,208,955**	**886,660**	**322,295**	**-**
5.1	**Qendra të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike të ngritura**					**532,114**	**532,114**	**-**	**-**
5.1.1	11 Qendra të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike në Tiranë dhe në rrethe të ngritura dhe funksionale	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	502,273	502,273	-	-
5.1.2	4 Njësi lëvizëse për ofrimin e shërbimeve publike në zonat rurale të ngritura dhe funksionale	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	29,841	29,841	-	-
5.2	**Administrimi i Sporteleve të Shërbimit (front-office) për publikun i ndarë nga zyrat përgjegjëse (back office) të shërbimit në institucionet qendrore**					412,455	354,546	57,909	-
5.2.1	Sportelet për 10 institucione qendrore të ndara (numri i sporteleve të marra në administrim)	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2022	177,273	177,273	-	-
5.2.2	Të paktën 60 sportele të shtuara me standard të përmirësuar për ofrimin e shërbimeve publike në të gjitha Qendrat e Integruara ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	177,273	177,273	-	-
5.2.3	Procedura të reja të brendshme dhe manualeve të institucioneve të përshtatura sipas standardeve të reja të punës	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2022	57,909	-	57,909	-
5.3	**Kuadri për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike i zhvilluar**					-	-	-	-
5.3.1	Kuadri për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike i hartuar dhe i miratuar	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2019	kosto administrative			
5.3.2	Cilësia e ofrimit të shërbimeve publike pranë qendrave të integruara dhe sporteleve të shërbimeve ADISA e monitoruar përmes (i)Raporteve periodike për vlerësimin e cilësisë; (ii)Lista e rekomandimeve të nxjerra	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2019	TM IV 2022	kosto administrative			
5.3.3	Zbatimi i kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike pranë institucioneve të qeverisjes qendrore i pilotuar përmes (i) Raporteve periodike për vlerësimin e cilësisë; (ii) Lista e rekomandimeve të nxjerra	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2019	TM IV 2022	kosto administrative			
5.4	**"Sportelet me një ndalesë" për shërbimet administrative në nivel vendor të krijuara**					**264,386**	**-**	**264,386**	**-**
5.4.1	Sistemi online për ofrimin e shërbimeve administrative të bashkive i pilotuar (lidhja e sistemeve front office me back office duke ndërlidhur në një sistem të vetëm njësitë administrative me njësitë qendër) (i) Numri i bashkive që aplikojnë programin e ri të shërbimeve on-line të ofruara nga sportelet unike; (ii) Numri i shërbimeve të ofruara; (iii) Në 3 bashki (TM IV 2018) dhe shtrirja e tij në bashkitë e mbetura (roll-out TM IV 2019)	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		TM I 2018	TM IV 2019	264,386	-	264,386	-
5.5	**Kapacitete institucionale të ADISA-s dhe institucioneve qendrore për rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të zhvilluara**					-	-	-	-
5.5.1	Stafi i administratës së brendshme (ADISA) i trajnuar (i) Numri i punonjësve të trajnuar (ADISA); (ii) Numri i trajnimeve të zhvilluara	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
5.5.2	Stafi i institucioneve qendrore i trajnuar (i) Numri i punonjësve të trajnuar (institucione qendrore); (ii) Numri i trajnimeve të zhvilluara	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
	Qëllimi i Politikës: Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore								
6	**OBJEKTIVI SPECIFIK 6** Rritja e kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil si dhe lehtësimi i procedurave në zbatim të tij					**72,801**	**15,214**	**50,598**	**6,989**

6.1	**Kapacitetet e DAP dhe strukturat e menaxhimit të burimeve njerëzore të forcuara për të udhëhequr strategjikisht reformën e shërbimit civil**					**47,267**	**9,216**	**44,051**	-
6.1.1	Komunikimi dhe ndërveprimi midis institucioneve publike dhe qytetarëve i përmirësuar dhe lehtësuar (krijimi i HUB-it për menaxhimin e burimeve) (i) Faza I: ndërtimi i strukturës/sistemit dhe pilotimi në institucionet kyç - ministri dhe disa institucione varësie deri në 100 përdorues. (ii) Faza II: zgerim në institucione dhe funksione - deri në 600 përdorues (Faza II fillon TM II 2019 dhe mbaron TM IV 2019 - zhvillim; trajnimi TM I 2020 - TM IV 2020). Hub i krijuar. Nëpunëst civilë të njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore të trajnuar për përdorimin e formateve të gatshme.	Departamenti i Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2022	26,000	-	26,000	-
6.1.2	Portali i integruar për ndërveprim dhe raportim administrata.al i plotësuar me bazë ligjore, procese dhe template për menaxhimin e burimeve njerëzore	Departamenti i Administratës Publike		TM I 2019	Në vijim	540	540	-	-
6.1.3	Kapacitete institucionale të ngritura për përdorimin e portalit administrata.al sipas moduleve	Departamenti i Administratës Publike		TM I 2019	Në vijim	742	742	-	-
6.1.4	Kapacitete të nëpunësve në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të komisionit përzgjedhës për të përmirësuar më tepër procesin e rekrutimit të forcuara/ Nr. i personave të trajnuar	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e Linjës	TM IV 2018	Në vijim	10,518	-	10,518	-
6.1.5	Udhëzues për hartimin e pyetjeve me zgjedhje të shumëfishta i hartuar	Departamenti i Administratës Publike		TM II 2019	TM IV 2019	383	-	383	-
6.1.6	Përshkrimet e punës të rishikuara dhe katalogu i përshkrimeve të punës i hartuar	Departamenti i Administratës Publike		TM III 2018	TM IV 2019	7,150	-	7,150	-
6.1.7	Proceset e punës në të gjitha ministritë e linjës të rishikuara	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e Linjës	TM I 2020	TM I 2021	180	180	-	-
6.1.8	Rjetet Profesionale të ngritura dhe funksionale në institucionet e administratës qendrore	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e Linjës	TM IV 2018	TM IV 2021	kosto administrative			
6.1.9	Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë i rishikuar dhe përmirësuar	Departamenti i Administratës Publike		TM IV 2018	TM I 2020	270	270	-	-
6.1.10	Kapacitete institucionale për përdorimin e manualit për legjislacionin e shërbimit civil të ngritura	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e Linjës	TM IV 2019	TM IV 2022	742	742	-	-
6.1.11	Kapacitete insitucionale për përdorimin e manualit të përshkrimeve të punës të ngritura	Departamenti i Administratës Publike	Ministritë e Linjës	TM IV 2019	TM IV 2022	742	742	-	-
6.2	**Procesi i rekrutimit i përmirësuar nëpërmjet marrjes së opinionit të publikut mbi procedurat e rekrutimit**					-	-	-	-
6.2.1	Vlerësime 'ad-hoc' (sipas rasteve) të kryera për të marrë opinionin e aplikantëve mbi procesin e rekrutimit dhe marrja e masave për të adresuar çështjet që dalin nga vlerësimi (i) Vlerësimet e kryera; (ii) Gjetjet e reflektuara; (iii) Masat e marra për adresimin e tyre të evidentuara në raportet e brendshme të DAP	Departamenti i Administratës Publike		TM III 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
6.2.2	Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për të përthithur studentët më të mirë në administratën publike (qendrore dhe vendore) përmes panaireve të punës, marrëveshjeve të bashkëpunimi, orëve të hapura, etj. (Panaire pune, marrëveshje bashkëpunimi, orë të hapura, etj.)	Departamenti i Administratës Publike	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore/Njësitë e Qeverisjes Vendore	TM IV 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
6.3	**Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ/HRMIS) i shtrirë në shkallë të gjerë dhe moduli i pagave i vënë në funksionim**					**5,070**	-	**5,070**	-
6.3.1	SIMBNJ në të gjitha institucionet e administratës publike i zgjeruar (i) 100% e institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil - TM IV 2018 (ii) 100% e institucioneve të administratës shtetërore,jo shërbim civil dhe institucionet e pavarura - TM II 2019; (iii) 100 % Bashkitë dhe qarqet - TM IV 2020	Departamenti i Administratës Publike	Institucionet e administratës publike	Në vijim	TM IV 2020	3,900	-	3,900	-
6.3.2	Bordero të gjeneruara nëpërmjet SIMBNJ për punonjësit e administratës publike (i) 80% e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimti civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ - TM IV 2018; (ii) 100% e administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ - TM II 2019; (iii) të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore jo shërbim civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ brenda TM IV 2019; (iv) NJQV gjenerojnë paga TM IV 2020	Departamenti i Administratës Publike	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	TM II 2018	TM IV 2020		-		-
6.3.3	Nëpunës të burimeve njerëzore dhe të njësive të financës të trajnuar për përdorimin e SIMBNJ (Të paktën 200 punonjës të trajnuar çdo vit (burime njerëzore dhe financë)	Departamenti i Administratës Publike	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Në vijim	TM IV 2022	1,170	-	1,170	-
6.4	**Niveli i zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore i ritur**					**2,160**	**2,160**	-	-
6.4.1	Moduli online (database) në lidhje me vendimet gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore në platformën administrata.al i monitoruar	Departamenti i Administratës Publike	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil/Ministritë e Linjës	TM I 2019	Cdo vit	720	720	-	-
6.4.2	Zbatimi i vendimeve gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore nëpërmjet procedurave administrative të komisioneve të posacme i monitoruar	Departamenti i Administratës Publike	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil/Ministritë e Linjës	TM I 2019	Cdo vit	1,440	1,440	-	-
6.5	**Zbatimi i ligjit për nëpunësin civil në nivel të rritur dhe aplikimi i tij në njësitë e qeverisjes vendore i unifikuar**					**6,989**	-	-	**6,989**
6.5.1	Zbatimi i ligjit në shërbimin civil me fokus administratën vendore, i unifikuar nëpërmjet mbikëqyrjeve dhe hetimit administrativ të ankesave, (i) Numri i mbikëqyrjeve të kryera) (ii)Numri i ankesave të regjistruara pranë Komisionerit (iii) Numri i vendimeve paralajmëruese (iv) Numri i vendimeve të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil		TM II 2018	në vijim	kosto administrative			
6.5.2	Ndryshimet ligjore të domosdoshme për të unifikuar zbatimin e ligjit në administratën shtetërore dhe vendore të hartuara dhe propozuara	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil		TM II 2019	TM IV 2019	kosto administrative			
6.5.3	Zbatimi i ligjit për nëpunësin civil gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2019 dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 i monitoruar	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil		TM II 2019/TM II 2021	TM III 2019/ TM III 2021	kosto administrative			
6.5.4	Zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, nëpërmjet seancave dëgjimore dhe hetimit administrativ, i monitoruar	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil		TM I 2019	Në vijim	kosto administrative			

6.5.5	Trajnime të përbashkëta të organizuara me ASPA-n për njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe nëpunës civilë të tjerë në NJQV, të ngarkuar me detyra të posaçme nga ligji për shërbimin civil, me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre dhe unifikimin e praktikave në shërbimin civil. i. Numri i institucioneve të përfshira në trajnim; ii. Numri i nëpunësve të trajnuar për aplikimin e procedurave administrative gjatë përdorimit të instituteve të ndryshme të ligjit.	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	TM II 2018	TM IV 2020	6,989	-	-	6,989
6.6	**Kapacitetet e KMSHC-së të ngritura për të mundësuar ushtrimin e plotë të mandatit të tij**					**9,838**	**9,838**	-	-
6.6.1	Struktura e KMSHC dhe rritja e numrit të stafit e rishikuar dhe miratuar (i) Struktura e miratuar; (ii) Nr i punonjësve shtesë	Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil	Kuvendi i Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë	TM II 2018	TM I 2020	9,838	9,838	-	-
6.7	**Kapacitete të punonjësve të përfshirë në riinxhinierizimin e proceseve dhe në ofrimin e shërbimeve të përmirësuara për publikun të rritura dhe të forcuara**					-	-	-	-
6.7.1	Asistenca 'online' e ofruar për punonjësit e administratës publike dhe trajnimi i tyre, për gjenerimin e dokumenteve shoqëruese të disponueshme me vulë dixhitale në portalin e-albania, në emër të qytetarit dhe biznesit	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	kosto administrative			
6.8	**Forcimi i vazhdueshëm i ASPA si ofrues i trajnimeve për burimet njerëzore me synimin e përgatitjes dhe zhvillimit të një administrate publike eficiente**					**1,477**	-	**1,477**	-
6.8.1	Sistem efektiv i zhvilluar për vlerësimin e trajnimit, që do të gjenerojë më shumë të dhëna lidhur me cilësinë e trajnimit, arritjen e objektivave dhe matjen e ndikimit të trajnimit në performancën individuale, të institucionit dhe të sistemit në tërësi (i) Vlerësime objektive dhe të pavarura periodike të cilësisë çdo 2 vjet; (ii) të paktën 2 vlerësime të ndikimit të programeve të trajnimit çdo vit	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
6.8.2	Kontakte të vendosura dhe bashkëpunim me agjenci profesionale në fushën e kontrollit të cilësisë për edukimin/trajnimin me qëllim ngritjen e një sistemi për menaxhimin dhe vlerësimin e cilësisë së trajnimeve (i) Hulumtim i kryer; (ii)Anëtarësimi në dy rrjete ndërkombëtare	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
6.8.3	Sisteme dhe procedura të zhvilluara që plotësojnë standardet kombëtare/ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë (i) Sigurimi i kontrollit të cilësisë së kurrikulave të trajnimit nëpërmjet sistemit të vlerësimit të kurrikulës (SVC); (ii) Sistemi i kontrollit të cilësisë i përshtatur me standardet kombëtare/ndërkombëtare	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
6.8.4	Sisteme që sigurojnë menaxhimin efektiv dhe efiçent të burimeve nëpërmjet mirëpërdorimit të burimeve njerëzore të brendshme të ASPA-s dhe ofrimit të shërbimeve për të tretët të zhvilluara (i) Nr. i kurseve të trajnimit për institucione/pjesëmarrës jashtë shërbimit civil (me pagesë) (ii) Nr. i konsulencave me qëllim sigurimin e të ardhurave	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
6.8.5	Sistem modern i zhvilluar për menaxhimin e informacionit lidhur me trajnim dhe nevojat për trajnim sipas kuadrit të HRMIS	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
6.8.6	Bibliotekia e ASPA (e-library) në funksionim dhe në proces pasurimi të vazhdueshëm	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	1,477	-	1,477	
6.8.7	Analizë e kuadrit aktual ligjor, evidentimi i nevojave dhe propozimet përkatëse për rishikimet ligjore	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM IV 2019	TM IV 2020	kosto administrative			
6.8.8	Analizë e kapaciteteve institucionale të ASPA-s për evidentimin e nevojave dhe propozimet përkatëse në riorganizimin e strukturës për të mundësuar ushtrimin e plotë të misionit të institucionit si shkollë e administratës publike	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2019	TM IV 2019	kosto administrative			
7	**OBJEKTIVI SPECIFIK 7** Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme					**19,890**	-	**19,890**	-
7.1	**Struktura e re e pagave e rishikuar dhe e miratuar**					**19,890**	-	**19,890**	-
7.1.1	Një dokument për politikat në sistemin e pagave dhe miratimi i strukturës së re të pagave i hartuar dhe i miratuar	Departamenti i Administratës Publike		TM IV 2018	TM IV 2019	19,890	-	19,890	-
7.1.2	Vendime të reja për pagat të miratuara dhe struktura e re e pagave e zbatuar	Departamenti i Administratës Publike		TM I 2020	TM IV 2021	kosto administrative			
7.1.3	Raportet mes pagës maksimale dhe pagës minimale/mesatare në administratën publike, të rishikuara me qëllim ruajtjen e një piramide objektive të pagave dhe motivimin e pozicioneve drejtuese si edhe diversifikimi i klasifikimit sipas përmbajtjes së punës	Departamenti i Administratës Publike		TM I 2020	TM IV 2021	dokumenti që do të hartohet në nënaktivitetin 7.1.1 do të përfshijë dhe një analizë të këtyre raporteve ndaj përfshihet tek kostoja e këtij aktivitetit			
	Qëllimi i Politikës: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja								
8	**OBJEKTIVI SPECIFIK 8** Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin					**17,105**	**9,435**	**7,670**	-
8.1	**Ri-inxhinierimi i shërbimeve publike, si një masë e nevojshme për thjeshtimin e procedurave administrative dhe uljen e numrit të hapave që duhet të ndërmarrin qytetarët dhe personeli mbështetës**					-	-	-	-
8.1.1	Procedurat e marrjes së shërbimeve në sportel të lehtësuara, nëpërmjet miratimit të akteve ligjore për reduktimin/ eliminimin e dokumenteve dhe/ose procedurave të punës (Numri i akteve ligjore të miratuara për reduktimin e dokumenteve)	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM II 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
8.1.2	Formularët e aplikimit për shërbimet publike të standardizuar nga ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
8.1.3	Shërbime për të cilat informacioni ofrohet nëpërmjet 3 sistemeve alternative (internetit, mobile app, call center) të ngritur nga ADISA të shtuara	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara		TM I 2018	TM IV 2022	kosto administrative			
8.2	**Derregullimi, si masë për reduktimin drastik të dokumenteve të kërkuara nga qytetarët/bizneset dhe kalimin në një nivel të ri të modernizimit dhe dixhitalizimit të tyre**					-	-	-	-
8.2.1	Procedura të lehtësuara të marrjes së shërbimeve nga biznesi dhe qytetarët, në institucionet e administratës publike, nëpërmjet shtimit të shërbimeve me vulë dixhitale (Nr. i shërbimeve elektronike (nivel 4) me vulë dixhitale në portalin e-Albania)	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të procesit të derregullimit			
8.2.2	Shërbime publike të modernizuara nëpërmjet ofrimit të tyre elektronikisht në portalin qeveritar e-albania	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të procesit të derregullimit			
8.3	**Krijimi i një mekanizmi që u mundëson qytetarëve të japin mendimin mbi cilësinë e shërbimeve elektronike në portalin e-albania**					-	-	-	-

8.3.1	Funksionaliteti i vlerësimit me yje të cilësisë së shërbimit për të gjitha shërbimet elektronike të portalit e-albania i vënë në zbatim (Nr i shërbimeve elektronike të pajisura me opsionin e vlerësimit me yje të cilësisë së shërbimit)	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2018	TM IV 2020 (e në vijim)				
8.4	**Krijimi i kushteve dhe procedurave për zbatimin me transparencë dhe objektivitet të promovimit në karrierë në shërbimin civil**					**17,105**	**9,435**	**7,670**	**-**
8.4.1	Nevojat për trajnim të identifikuara në mënyrë periodike nëpërmjet organizimit të procesit të Analizës së Nevojave për Trajnim (ANT) (i) Metodologjia e vlerësimit të nevojave e hartuar dhe e miratuar; (ii) Vlerësimi i nevojave gjithëpërfshirëse për trajnim çdo 3 vjet; (iii) Vlerësimi i nevojave specifike për trajnim çdo vit; (iv) Raport përmbledhes i nevojave për trajnim	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
8.4.2	Trajnime në numër më të madh të ofruara në fushën e integrimit evropian në përputhje me hapjen e procesit të negociatave	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	13,875	6,205	7,670	-
8.4.3	Kapacitetet trajnuese të ekspertëve (trajnerëve) të përditësuara dhe të zhvilluara	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	1,359	1,359	-	-
8.4.4	Metodologjia e hartuar nga ASPA për zhvillimin e vazhdueshëm profesional në institucionet e administratës shtetërore e zbatuar	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM III 2018	TM IV 2021	kosto administrative			
8.4.5	Plane vjetore të zhvilluara për trajnimin e drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë – bazuar në ofertën e trajnimit për TND	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2020	1,379	1,379	-	-
8.4.6	Qasje alternative të vlerësuara në lidhje me trajnimin e drejtuesve duke përfshirë edhe qasjen e bazuar tek kompetenca dhe pilotimi në institucione të caktuara	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM II 2018	TM IV 2020	kosto administrative			
8.4.7	Numri i moduleve të trajnimeve të realizuara nëpërmjet platformës e-learning i rritur	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike		TM I 2018	TM IV 2020	492	492	-	-
9	**OBJEKTIVI SPECIFIK 9** Zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe ritjen e efiçensës duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit					**-**	**-**	**-**	**-**
9.1	**Kanalet e ofrimit të shërbimeve elektronike të portalit qeveritar e-albania të diversifikuara**					**-**	**-**	**-**	**-**
9.1.1	Entitete që ofrojnë shërbimet elektronike të portalit e-albania të shtuara. Nr. i entiteteve që ofrojnë shërbimet elektronike të portalit e-albania	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM II 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	kosto e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas vendosjes së numrit të entiteteve që do të ofrojnë shërbimet elektronike të portalit e-albania të shërbimeve të reja elektronike në modulin "ONE STOP SHOP për nëpunësit qeveritarë"			
9.2	**Regjistrat themeltarë të dixhitalizuara, interoperabiliteti dhe ngritja e sistemeve të reja IT**					**-**	**-**	**-**	**-**
9.2.1	Proces i vijuar i dixhitalizimit të regjistrave themeltarë të institucioneve të qeverisjes qendrore. Nr. i regjistrave të dixhitalizuar (*TBD nr regjistrave sipas viteve per t'u percaktuar)	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2019	TM IV 2020 (e në vijim)	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve për regjistrat e qeverisjes qendrore e do të dixhitalizohen			
9.2.2	Sisteme të shtuara të institucioneve të lidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, për të: (i) mundësuar komunikimin në kohë reale me njëra-tjetrën, (ii) lehtësuar aplikimet online si dhe (iii) reduktuar dokumentet shoqëruese në sportele	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM IV 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas përfundimit të identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve për numrin e sistemeve që do të shtohen			
9.2.3	Sisteme të reja të institucioneve që nuk kanë sistem të brendshëm përpunimi të aplikimeve dhe dosjeve me të dhënat e qytetarëve (sistemet backend). Zhvillimi i sistemeve të përpunimit të aplikimeve dhe dosjeve me të dhënat e qytetarëve (sistemet backend), për institucionet ku këto sisteme mungojnë të zhvilluara.	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM I 2019	TM IV 2020 (e në vijim)	kostoja dhe afatet e këtij aktiviteti do të përcaktohen pas përfundimit të identifikimit dhe vendosjes së prioriteteve për regjistrat që do të dixhitalizohen			
9.3	**Sisteme të integruar TIK për sportelet e ofrimit të shërbimeve të institucioneve qendrore për qytetarët të zhvilluara dhe në përdorim**					**-**	**-**	**-**	**-**
9.3.1	Shërbime të reja elektronike të përfshira në Modulin "ONE STOP SHOP" për nëpunësit qeveritarë	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit		TM II 2018	TM IV 2020 (e në vijim)	kostoja e këtij aktiviteti do të përcaktohet pas identifikimit të shërbimeve të reja elektronike në Modulin "ONE STOP SHOP për nëpunësit qeveritarë"			
10	**OBJEKTIVI SPECIFIK 10** Ritja e efiçencës dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë					**298,740**	**-**	**298,740**	**-**
10.1	**Metoda të reja për rritjen e eficencës, përgjegjshmërisë, angazhimit dhe motivimit të punonjësve publikë të aplikuar të aplikuara**					**298,740**	**-**	**298,740**	**-**
10.1.1	Administrata publike e trajnuar për zbatimin e kodit të procedurave administrative sipas kurrikulës së ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike	Ministritë e Linjës/Njësitë e Qeverisjes Vendore	TM II 2018	TM IV 2020	13,000	-	13,000	-
10.1.2	Instrumente të rinj për të përmirësuar kulturën organizative në institucionet shtetërore të aplikuar	Departamenti i Administratës Publike	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/Ministritë e linjës	TM III 2018	TM IV 2021	25,740	-	25,740	-
10.1.3	Programi 'Young Civil Servant Scholarship Scheme' i zbatuar dhe i qëndrueshëm	Departamenti i Administratës Publike	Kryeministria/Shkolla Shqiptare e Administratës Publike /Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	TM IV 2020	TM IV 2022	260,000	-	260,000	-
11	**OBJEKTIVI SPECIFIK 11** Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion					**58,542**	**4,070**	**210**	**54,262**
11.1	**Programi institucional i transparencës nga autoritetet publike i vënë në zbatim**					**36,664**	**-**	**-**	**36,664**
11.1.1	Programet e transparencës të miratuara dhe zbatuara (për të gjitha autoritetet publike që ende nuk kanë një program transparence) dhe/ose të plotësuara (për autoritetet publike që e kanë të paplotë) dhe/ose të përditësuara rregullisht (për autoritetet publike që kanë programe të plota transparence por nuk i përditësojnë ato rregullisht) për të gjitha institucionet e administratës qendrore	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM I 2018	TM IV 2022	16,464	-	-	16,464

11.1.2	Programet model të transparencës për pushtetin vendor të hartuara	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM II 2018	TM I 2019	3,736	-	-	3,736
11.1.3	61 koordinatorë të së drejtës për informim në pushtetin vendor të trajnuar	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM I 2019	TM IV 2019	16,464	-	-	16,464
11.1.4	Programet e transparencës të miratuara dhe të zbatuara në të gjitha bashkitë	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM I 2019	TM IV 2022		-	-	
11.2	**Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës**					**15,638**	**1,670**	**210**	**13,758**
11.2.1	Regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve i vënë në funksionim të plotë	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		Në proces (nisur në 2017)	TM IV 2022	15,438	1,470	210	13,758
11.2.2	Koordinatorët për të drejtën e informimit të trajnuar lidhur me përdorimin e regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve.	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM IV 2020	TM IV 2022	200	200	-	-
11.3	**Rishikimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit me synim përmirësimin e: a) përmbajtjes dhe metodës së zbatimit të programeve të transparencës; b) mekanizmave të përgjegjësisë administrative; dhe c) rritjen e publikimit proaktiv të informacionit publik**					**2,340**	**-**	**-**	**2,340**
11.3.1	Vlerësim të plotë ex-post të Ligjit për të Drejtën e Informimit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM I 2019	TM II 2020	2,340	-	-	2,340
11.4	**Kapacitetet e burimeve njerëzore të KDIMDP për monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit të ngritura**					**3,900**	**2,400**	**-**	**1,500**
11.4.1	Struktura e KDIMDP e rishikuar me synimin forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit (i) Struktura e miratuar; (ii) Nr. i punonjësve të shtuar	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM II 2018	TM IV 2018	kosto administrative	-	-	-
11.4.2	Kapacitete të forcuara përmes trajnimeve të zhvilluara në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale (i) Nr. i personave të trajnuar; (ii) Nr. i kurseve të trajnimit	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale		TM II 2018	TM IV 2022	3,900	2,400	-	1,500
						1,972,158	**944,391**	**875,535**	**152,232**

VENDIM
Nr. 698, datë 30.10.2019

PËR HAPJEN E MISIONIT TË POSAÇËM TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KIEV, UKRAINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e Misionit të Posaçëm të Republikës së Shqipërisë në Kiev, Ukrainë.

2. Misioni i Posaçëm në Kiev, Ukrainë, do të ndjekë zhvillimet politike në vend dhe do të pasqyrojë aktivitetin e grupit tripalësh të Kontaktit të OSBE-së për Ukrainën, në kuadër të marrjes së kryesisë së radhës së OSBE-së nga Shqipëria për vitin 2020, deri në mbarimin e kryesisë së radhës së OSBE-së nga Shqipëria.

3. Misioni i Posaçëm do të drejtohet nga një diplomat karriere, me gradën diplomatike "Ministër Këshilltar", i cili do të qëndrojë në këtë detyrë deri në mbarimin e misionit të posaçëm.

4. Shpenzimet për hapjen e këtij misioni të përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, miratuar për vitin 2019.

5. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 700, datë 30.10.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 230, DATË 13.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR TRAJTIMIN ME PAGESË TË QIRASË SË DISA FAMILJEVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT 'UNAZA E MADHE E TIRANËS, SEGMENTI KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS'", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 30 e 33, të ligjit nr. 9232 datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 1/3, shtohet pika 1/4, si më poshtë vijon:

"1/4. Familjet, sipas listës 2/4, përfitojnë subvencionimin e qirasë nga data 16.11.2018, sipas verifikimit të Njësisë Bashkiake nr. 6, të Bashkisë Tiranë. Shpenzimet për mbulimin e qirasë deri në fund të vitit 2019 mbulohen nga fondet e strehimit, të planifikuara në buxhetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.".

b) Pas lidhjes 2/3, shtohet lidhja 2/4, me listën emërore të subjekteve që do të trajtohen me qira, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Enti Kombëtar i Banesave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Shtojca 2/4

Lista emërore e subjekteve që trajtohen me qira

Subjektet, të cilat preken nga zbatimi i projektit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës, që trajtohen me pagesën e qirasë	
1	Klodian Gjalpi
2	Alfons Gjalpi

VENDIM
Nr. 701, datë 30.10.2019

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "ROZAFA" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE "SEKTORI AUTOPARK, ISH-PARKU I MINIERËS SË HEKUR-NIKELIT, PËRRENJAS", ME NUMËR PASURIE 4/240, ZONA KADASTRALE 2924, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË NDËRMARRJES INDUSTRIALE NR. 1, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, 'Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve'", dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Rozafa" sh.p.k, si qiramarrës, për pasurinë shtetërore "Sektori autopark, ish-Parku i Minierës së Hekur-Nikelit, Përrenjas", me sipërfaqe të përgjithshme 10 287.3 m^2, nga ku sipërfaqe ndërtimore 1 090.5 m^2 dhe sipërfaqe funksionale 9 196.8 m^2, me numër pasurie 4/240, zona kadastrale 2924, në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË
Nr. _____ rep.
Nr. _____ kol.

DRAFTKONTRATË QIRAJE
Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata
Lidhur

Në Tiranë, sot më datë _____, të muajit _____, të vitit 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), u paraqitën para meje noterit_____, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përfaqësuar me autorizim të ministrit, nr. _____ nga z/znj. _____ me detyrë _____, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, i datëlindjes __/__/_____, banues në _____, me shtetësi shqiptare i/e pajisur me letër njoftimin nr. _____, që më poshtë do të quhet "**QIRADHËNËSI**"

DHE

Shoqëria "Rozafa" sh.p.k., me seli qendrore në Tiranë, me adresë: rruga "Luigj Gurakuqi"

Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT: K48130547V, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë znj. Lisena Metoshi, e bija e Xhevit, e datëlindjes 30.2.1983, lindur në Elbasan dhe banuese në Elbasan, me shtetësi shqiptare, identifikuar me letër njoftimi personal me nr. _____që më poshtë do të quhet "**QIRAMARRËSI**".

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, në zbatim të vendimit nr. ____, datë __.__.____, të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Qiradhënës dhe Shoqërisë "Rozafa" sh.p.k. si Qiramarrës, për pasurinë *"Sektori AUTOPARK" ish-Parku i Minierës së Hekur-Nikelit, Përrenjas, me sipërfaqe të përgjithshme 10 287.3 m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 1 090.5 m² dhe sipërfaqe funksionale 9 196.8 m², me nr. pasurie 4/240, ZK 2924",* në përgjegjësi administrimi të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me "Qiramarrësin", palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë:

Neni 1
Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë shtetërore *"Sektori AUTOPARK" ish-Parku i Minierës së Hekur-Nikelit, Përrenjas, me sipërfaqe të përgjithshme 10 287.3m², nga ku sipërfaqe ndërtimore 1 090.5 m² dhe sipërfaqe funksionale 9 196.8 m², me nr. pasurie 4/240, ZK 2924",sipërfaqe të përgjithshme 28 960 m², në të cilën përfshihet "Ish-Reparti Ushtarak nr. 5012/20, me vendndodhje në Përrenjas, Librazhd, në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë,* sipas genplanit dhe dokumentit të ZVRPP-së Librazhd.

Neni 2
Qëllimi i përdorimit

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, për ngritjen e fabrikës, si dhe të gjitha ambienteve ndihmëse në funksion të saj, për përpunimin e karkalecit sipas Autorizimit për përdorimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv, mbi mallin e porositësit.

Neni 3
Kohëzgjatja

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzetë) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit

4.1 "Qiradhënësi", nëpërmjet, Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, si njësia që ka në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e "Qiramarrësit".

4.3 "Qiradhënësi" ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësisë monitoruese të kontratës së qirasë, Ndërmarrjes Industriale nr. 1, Tiranë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 "Qiradhënësi" është i detyruar të garantojë "Qiramarrësin" për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë.

4.5 "Qiradhënësi" ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 "Qiradhënësi" nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve që nuk pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit

5.1 "Qiramarrësi" ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën

e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 "Qiramarrësi" ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar për mjedisin dhe konventat ndërkombëtare për mjedisin në të cilat aderon Republika e Shqipërisë.

5.3 "Qiramarrësi" detyrohet që për zhvillimin e aktivitetit, të jetë i pajisur me Autorizimin për përpunimin aktiv të mallrave , lëshuar prej institucioneve shtetërore, aktualisht Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Një kopje e autorizimit, si dhe gjithmonë kur ai përsëritet, duhet të paraqitet edhe te Qiradhënësi.

5.4 "Qiramarrësi" detyrohet që, në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në plan biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.5 "Qiramarrësi" detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.6 "Qiramarrësi" detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.7 "Qiramarrësi" detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.8 "Qiramarrësi", Shoqëria "Rozafa" sh.p.k., sipas planbiznesit të paraqitur në konkurrim do të investojë për rikonstruksionin total të kapanoneve ekzistuese për ti kthyer, në një fabrikë për përpunimin e karkalecit, si dhe në mjedise frigoriferike në shërbim të fabrikës, si dhe lëndëve ndihmëse jo me bazë peshku (ambalazhe, lëndë e parë që nuk nevojitet frigorifer). Gjithashtu do të investohet në të gjithë infrastrukturën ndihmëse të rrjetit të kanalizimeve, trajtimit të ujërave, rrugët lidhëse dhe infrastruktura tjetër rrugore, elektrike dhe hidraulike.

Në objekt do të instalohen makineri e pajisjet e nevojshme, që do të jenë pjesë përbërëse e një teknologjie bashkëkohore, e cila i plotëson të gjitha kërkesat teknike konform standardeve të Bashkimit Evropian.

Financimi i projektit parashikohet në vlerën prej 86 709 411 (me TVSH), dhe do të përfundojë brenda 18 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse.

Sipas planbiznesit, projekti që do të realizohet është si më poshtë:

- investime në infrastrukturë 71 002 982 lekë,
- në makineri e pajisje 11 746 429 lekë,
- në pajisje pune (tavolina, karrige, dollapë) 3 960 000 lekë.

Financimi i projektit dhe investimeve do të bëhet nga fondet e vetë shoqërisë "Rozafa" sh.p.k., vërtetuar me bilancin paraprak për 6-mujorin e parë të vitit 2019 dhe vërtetimi për eksportet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Shoqëria, nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, brenda 18 muajve do të investojë në total **86 709 411 (me TVSH), dhe do të përfundojë brenda 18 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse.**

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.9 "Qiramarrësi", sipas parashikimit për punësimin të shprehur sipas plan biznesit të paraqitur në konkurrim që, me përfundimin e investimit, i cili do të përfundojë 18 muaj nga data e marrjes së dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së lejeve përkatëse, merr përsipër të punësojë **100 (njëqind) punonjës** të rinj.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.10 "Qiramarrësi" detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.11 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër sipas neneve 5.8 dhe 5.9, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe leje mjedisore nga organet kompetente.

5.12 "Qiramarrësi" detyrohet që, para përfundimit të vitit të pestë të përdorimit të objektit me qira sipas kësaj kontrate, të paraqesë para Qiradhënësit shtesën e plan biznesit për treguesit e periudhës në vijim, brenda objektit të kontratës dhe

pa ulur treguesit e shprehur në pikat 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate.

5.13 "Qiramarrësi" detyrohet që nëpërmjet Ndërmarrjes Industriale nr. 1 Tiranë, të paraqesë tek "Qiradhënësi" në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.14 "Qiramarrësi" detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.15 "Qiramarrësi", në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. "Qiradhënësi" nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga "Qiramarrësi".

5.16 Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.17 "Qiramarrësit" nuk i lejohet, që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.18 "Qiramarrësi", në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.8 dhe 5.9, detyrohet që, të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.19 "Qiramarrësi" në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt kontrate.

5.20 Shitja e kuotave të aksioneve apo ndryshimi i ortakëve të shoqërisë qiramarrëse, do të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të "qiradhënësit".

Neni 6
Pagesa e qirasë

6.1 "Qiramarrësi" detyrohet t'i paguajë "Qiradhënësit" detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro. Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës "Qiramarrësi" ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën _____ lekë, sipas faturës së lëshuar nga "Qiradhënësi", e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.8 të kësaj kontrate.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, "Qiramarrësi" do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e "Qiradhënësit" sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
Penalitetet

7.1 Në rastin kur "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, sipas përcaktimeve në pikën 5.8, të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, "Qiradhënësi" zgjidh kontratën dhe gjobit "Qiramarrësin" me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur, "Qiramarrësi", në përfundim të çdo faze, nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.9, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve,

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet për shkak të një force madhore,

c) kur "Qiramarrësi" shkel detyrimet e marra përsipër në nenet 5 dhe 6 të kësaj kontrate,

d) kur "Qiramarrësi" ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata,

e) kur prona nevojitet për interes publik,

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi,

g) kur "Qiramarrësi" nuk pajiset me autorizim për përpunim aktiv të mallrave, ose rifreskimin e tij, për një periudhë mbi 5 (pesë) muaj.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të "Qiradhënësit" për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse "Qiramarrësi" nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
Përgjegjësitë e palëve

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga "Qiramarrësi", sipas pikave 5.8 dhe 5.9 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, Ndërmarrjes Industriale nr. 1 Tiranë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të shoqërisë shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët, "Qiramarrësi" dhe Ndërmarrja Industriale nr. 1 Tiranë, janë të detyruar që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste palët janë të detyruara të njoftojnë njëra tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 "Qiramarrësi" përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të Forcës Madhore dhe mos kryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
Dispozitat e fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'i referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë Plan biznesi i paraqitur para komisionit të konkurrimit dhe proces verbali i marrjes në dorëzimi të objektit, sipas kontratës së qirasë.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

10.4 Në çdo rast të kalimit të mosmarrëveshjeve, të lindura mes palëve në juridiksion gjyqësor, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

Brenda një muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen "Qiramarrësit".

Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi ju lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter _____, në bazë te nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

QIRADHËNËSI
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

QIRAMARRËSI
Shoqëria "Rozafa" sh.p.k.


PLAN - RILEVIMI
PERGATITI
IDENTIFIKIMI I PASURISE
STUDIO PROJEKTIM IRGEN SGT GROUP
LICENSA NR 6806 KAT
DATE: 28 - 02 - 2019
DATA E PERGATITJES: 13 - 06 - 2019
ZONA KADASTRALE NUMER:2924
NUMERI I PASURISE:4/240 VOL 15 .FQ.61 ;
INDEKSI I HARTES : E - 3
SHKALLA: 1 :1000
ADRESA E PASURISE:PRENJAS
Q/F :PRRENJAS RRETHI :LIBRAZHD
PALL/GOD: SHKALLA: KATI:
APARATAMENTI:
PRONAR: NDERMARJA INDUSTRIALE NR 1 .
Sip truall =10 287.3m².
Sip ND = 1 090.5m².
Sip funksionale = 9 196.8m².
NDERMARJA INDUSTRIALE NR 1
DREJTOR
EDLIRA PERFUNDI

VENDIM
Nr. 702, datë 30.10.2019

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 564, DATË 29.9.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHURIMIN UNESCO-S TË IKONËS 'NGJALLJA E LLAZARIT', NË KUADËR TË 60-VJETORIT TË ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË KËTË ORGANIZATË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 564, datë 29.9.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për dhurimin UNESCO-s të ikonës 'Ngjallja e Llazarit', në kuadër të 60-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë".

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 703, datë 30.10.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NR. 316, ZONA KADASTRALE 2281, BASHKIA CËRRIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me nr. 316, zona kadastrale 2281, fshati Cërrik Fermë, Bashkia Cërrik, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Elbasan, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me nr. 316, zona kadastrale 2281, Bashkia Cërrik.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Elbasan, Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr.1

Nr. rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja m²	Sip. që përdoret për zhvillim m²	Sip. ndërtimore m²	Emërtimi i strukturës
1	Elbasan	Cërrik	2281	Cërrik -Fermë	316	109285	9038	1307.5	Objekt Magazinimi 1 kat
2			1389		3/129	4158		652.5	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1976588

PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit ELBASAN Zona Kadastrale Nr. 2281

Numri i Pasurisë 316 Volumi 2 Faqe 160

Adresa e Pasurisë CERRIK-FERME

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 109285

Nga kjo : Sa Truall Nga kjo : Sa Ndërtesa

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri Atësia Mbiemri	Pjesa	Adresa
REPUBLIKA E SHQIPERISE (NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI TE MINISTRISE SE BUJQESISE, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE)	I	

- është pronar i 316
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V 358/2 , L 358/2 , J zk1389 , P 371

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Data e lëshimit të çertifikatës
4.9.2019

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë Nr.

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI
KLEVIS XHOXHI

HARTA KADASTRALE

(Fragment)

AGJENSIA SHTETERORE E KADASTRES
DREJTORIA VENDORE
ELBASAN

DREJTORI
Klevis Xhoxhi

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 2281 NR.PASURISE 316 VOL. 2 Fq.160
INDEKSI I HARTES K-34-100-(240-B) SHKALLA 1:5000
ADRESA E PASURISE: RRETHI ELBASAN Q/F CERRIK-FERM
Rr/L "_____" P/G___SH__K__Ap

B. KUFIZIMET

V. 358/2
L. 358/1
J. Z.K1389
P. 371

C. PRONARI

SHTET
REPUBLIKA E SHQIPERISE

D.DATA:04/09/2019 ORA.10:00



SIPERFAQJA E PASURISE ARE= 109.285M²



...i. Nr. 519, Date 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUJTSHME

Vol. 2 , Fq. 160

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Vijon nga: Vol. ____ , Fq.

Zona Kadastrale 2281 NR i PASURISE 316

Vijon ne: Vol. ____ , Fq. ____ deri ne : Vol. ____ , Fq. ____ ---»

Indeksi i Hartes k-34-100-(240-c)

PERFUNDIMTARE (data) : __ / __ /

Adresa e Pasurise : Rrethi ELBASAN Q/F CERRIK-FERME

Rr/L _____ P/G ____ Sh ____ K ____ Ap

Pershkrim i Vecante

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurise : ARE	Brenda V . k . N. : Jo ----» Po , Ref :

Sip. Totale e Pasurise	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Totale: sa Ndertese	Per pjesen e perbashket:
1. _____ m² Ref	1. _____ m² Ref	1. _____ m² Ref	PALLAT
2. 109285 m² Ref LNSHTATOR99	2. _____ m² Ref	2. _____ m² Ref	Kuota e Pjesmarrjes: _____ %
3. _____ m² Ref	3. _____ m² Ref	3. _____ m² Ref	Nr . i Pasurise (Pallat):
4. _____ m² Ref	4. _____ m² Ref	4. _____ m² Ref	Vol. ____ , Fq.

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrim	Emri Atesia Mbiemri	Nr. Pasaport	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lesh. Certifikates	Shenime	Firma
LNSHT99	10.10.99	SHTETI		I					

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARRVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data Regjistrim	Tipi	Pershkrimi	Data e Lesh. Certifikates	Shenime	Firma
01776	13.1.2017	VKM820 DT.13.10.10	SIPAS VKM 820 DT.13.10.2010 KJO PASURI KALON NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI MINISTRISE BUJQESISE ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE	4.9.2019		
01803	24.2.2017	K.QERAJE	NE KETE PASURI REGJISTROHET KONTRATA E QIRASE NR. 1147/233/2 DT. 25.5.16 LIDHUR MIDIS MINISTRISE BUJQESISE ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TE UJRAVE (NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI) PERFAQESUAR NGA ZNJ. LAURESHA GREZDA DHE FIRMA "IGLA "SHPK ME PERFAQESUES LIGJOR Z.EDMOND DIZDARI ME AFAT 90 VJECAR			

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE etj.

Nr. Dok	Data Regjistrim	Tipi	Pershkrimi	Data e Lesh. Certifikates	Shenime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme
Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Elbasan
Adresa: Lagja "Brig.17 S", Rr "11 Nentori" (prane Prefektures) *Tel&Fax* ++35554 259 083

Elbasan , me

Shenim : Kjo kopje kartele A4 ka fuqi te njejte me origjinalin e ndodhur ne zyren tone ne volumin Nr. 2 , faqe 160 , te zones kadastral 2281 FSHATI CERRIK-FERME

REGJISTRUESI

KLEVIS XHOXHI

VENDIM
Nr. 705, datë 30.10.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 19, DATË 16.1.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT 'PËR RIKUALIFIKIMIN URBAN DHE ZHVILLIMIN E BLLOKUT NR. 2, QENDRA E QYTETIT ROSKOVEC'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 19, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, vlera prej 24 435 412 (njëzet e katër milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekësh ndryshon dhe bëhet 30 755 074 (tridhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë.

b) Pika 4, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit "truall" dhe "ndërtesë", me vlerë 30 755 074 (tridhjetë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë, të përballohet, si më poshtë vijon:

24 435 412 (njëzet e katër milionë e katërqind e tridhjetë e pesë mijë e katërqind e dymbëdhjetë) lekë, nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë;

6 319 662 (gjashtë milionë e treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2019".

c) Pika 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Shpenzimet procedurale në vlerën 169 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen, si më poshtë vijon:

50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, nga buxheti i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

119 000 (njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë, për botimin në organet e shtypit, nga Bashkia Roskovec.

ç) Tabelës bashkëlidhur vendimit, i shtohet tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Roskovec dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKM-në NR. 19, DATË 16.1.2019

Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Për rikualifikimin urban dhe zhvillimin e bllokut nr. 2, qendra e qytetit Roskovec"

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Nr. pasurisë	ZK	Sip. truallit e prekur m²	Çmimi lekë/m²	Vlera e truallit	Sip. ndërtesës së prekur	Çmimi i ndërtesës lekë/m²	Vlera e ndërtesës	Vlera totale	Shënime sqaruese
1	Bashkëpronarët: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli	2/362	3196	85	494	41990				41990	**Vërtetim hipotekor**
2	Bashkëpronarët: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli	2/363	3196	147	494	72618				72618	**Vërtetim hipotekor**
3	Bashkëpronarët: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli	2/352	3196	144	494	71136				71136	**Vërtetim hipotekor**
4	Bashkëpronarët: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli	2/353	3196	375.5	494	185497				185497	**Vërtetim hipotekor**
5	Bashkëpronarët: Mirjana Kongoli, Hajrie Shehu, Ymid Resuli, Mehdije Hoxha, Eqerem Risilia, Jolldiz Bedini, Rubie Risilia, Kujtim Kryeziu, Xheladin Kryeziu, Pranvera Kryeziu, Muharrem Resuli, Et'hem Resuli, Umberto Resuli	2/354	3196	153	494	75582				75582	**Vërtetim hipotekor**
6	Qani Haxhi Vidhishta	2/351	3196	72	494	35568				35568	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën datë 17.4.2019**
7	Qazim Sherif Shurdha	2/347	3196	20	494	9880				9880	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën datë 17.4.2019**
8	Qazim Sherif Shurdha	2/348	3196	40	494	19760				19760	**Vërtetim hipotekor**
9	Vladimir Hamit Pelo	2/288	3196	60	494	29640				29640	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën datë 17.4.2019**

10	Mareglen Avdul Hazizi	2/170+1-3	3196				70	30000	2100000	2100000	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019**
11	Mareglen Avdul Hazizi	2/170+1-2	3196				37	30000	1110000	1110000	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019; Inskriptohet në favor të BankëS Societe Generale Albania kontrata nr. 2003 rep, 714 kol, dt. 13.5.20136**
12	Mareglen Avdul Hazizi	2/170+1-2	3196				8.4		207692	207692	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019**
13	Mareglen Avdul Hazizi	2/170-N1	3196				46.7		1319417	1319417	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019; Inskriptohet në favor të Bankës Societe Generale Albania kontrata nr. 3334 rep, 1615 kol, dt. 7.12.2016**
14	Mareglen Avdul Hazizi	2/170	3196	103	494	50882				50882	**Vërtetim hipotekor**
15	Gazmend Dervish Canta Laureta Hysen Canta	2/170+1-1	3196				33	30000	990000	990000	**Konfirmuar nga ZVRPP Fier, me shkresën nr. 2714/1 prot, datë 12.7.2019**
Vlera Totale				**1199.5**		**592553**	**195**		5727109	**6319662**	

Shënim. 1. Vlerësimi për objektet është kryer bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.3.2000.
2. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë truall", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.

VENDIM
Nr. 706, datë 31.10.2019

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Arlind Gjokuta, drejtor i Përgjithshëm i Doganave, lirohet nga kjo detyrë.
2. Z. Gjon Bardhi emërohet drejtor i Përgjithshëm i Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 7, datë 22.10.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRGJITHSHME TË MENAXHIMIT TË TRAFIKUT TË KOMUNIKIMEVE, SI DHE MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PËRDORUESVE[1]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 4, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike që ofrojnë aksesin në internet, të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të menaxhimit të trafikut në ofrimin e shërbimit të aksesit në internet, si dhe të drejtat e përdoruesve fundorë.

2. Ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të ofrojnë informacion për çdo procedurë të vendosur prej tyre mbi matjen dhe drejtimin e trafikut me qëllim shmangien e ngarkesës ose mbingarkesës së lidhjeve të rrjetit, si dhe se si këto procedura mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit.

3. Përdoruesit fundorë kanë të drejtë të marrin akses në informacionet dhe përmbajtjen e ofruar në internet sipas parashikimeve që burojnë nga legjislacioni i posaçëm, në lidhje me ligjshmërinë e përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve të komunikimit elektronik.

4. Përdoruesit fundorë kanë të drejtë t'i shpërndajnë informacionet e përmendura në pikën 3, si dhe të përdorin dhe/ose ofrojnë aplikacione dhe shërbime, të përdorin pajisje fundore sipas zgjedhjes së tyre, pavarësisht nga vendndodhja e përdoruesit apo e ofruesit të shërbimeve ose pavarësisht nga vendndodhja, origjina ose destinacioni i informacioneve, përmbajtjeve, aplikacioneve ose shërbimeve, nëpërmjet shërbimit të aksesit në internet.

5. Kontratat e pajtimit, midis ofruesve të shërbimeve të aksesit në internet dhe përdoruesit fundor mbi kushtet dhe karakteristikat tregtare e teknike të shërbimit të aksesit në internet, si për tarifat, volumin e të dhënave ose për shpejtësinë e lidhjes, si dhe praktikat tregtare të aplikuara nga ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet. nuk e kufizon ushtrimin e të drejtave të përdoruesve fundorë sipas kërkesave të parashikuara në pikat 3 dhe 4 të këtij udhëzimi.

6. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet, gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve, trajtojnë të gjithë trafikun e komunikimit të të dhënave në të njëjtën mënyrë, pa diskriminime, kufizime ose ndërhyrje, pavarësisht nga burimi dhe destinacioni i përmbajtjes, nga aplikacionet ose shërbimet e përdorura ose të ofruara apo nga pajisjet fundore të përdorura.

7. Kërkesat e parashikuara në pikën 6 të këtij udhëzimi nuk e ndalojnë ofruesin e shërbimeve të aksesit në internet të zbatojë masa të arsyeshme për menaxhimin e trafikut. *AKEP-i me anë të një rregulloreje mund të specifikojë/detajojë rastet e menaxhimit*

[1] *Ky udhëzim përafron pjesërisht me rregulloren (BE) 2015/2120, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 nëntor 2015, që përcakton masat në lidhje me një akses të lirë të internetit dhe që modifikon Direktivën 2002/22/KE të shërbimit universal dhe të të drejtave të përdoruesve në fushën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik dhe rregulloren (BE) nr. 531/2012, në lidhje me shërbimin roaming në rrjetet publike të komunikimeve mobile brenda Bashkimit Evropian.*

të arsyeshëm të trafikut, si dhe kërkesat për cilësinë e shërbimit në lidhje me menaxhimin e trafikut.

8. Me qëllim mbrojtjen e të drejtave të përdoruesve, ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet marrin masa që kontratat që përfshijnë shërbime të aksesit në internet:

a) Të saktësojnë minimalisht informacionin mbi impaktin e mundshëm që mund të kenë masat për menaxhimin e trafikut, të aplikuara nga ofruesi mbi cilësinë e shërbimeve të aksesit në internet, mbi jetën private të përdoruesve fundorë dhe mbi mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

b) Të japin shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të pasojave që mund të vijnë si rezultat i kufizimeve të volumit, shpejtësisë dhe të parametrave të tjerë të cilësisë së shërbimit, për shërbimet e aksesit në internet dhe në veçanti mbi përdorimin e përmbajtjeve, aplikacioneve dhe shërbimeve,

c) Të japin shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm të pasojave në rastet e optimizimit të trafikut dhe shpejtësisë së aksesit.

Kontrata e pajtimtarit duhet të përmbajë informacion mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rast të shkeljeve të përsëritura apo mospërmbushjes së cilësisë së shërbimit të kontraktuar.

9. Ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet të parashikojnë procedura transparente, të thjeshta dhe eficiente për të trajtuar ankesat e përdoruesve fundor, publikohen në faqen e tyre të internetit dhe vihen në dispozicion në pikat e shitjes.

10. AKEP-i mbikëqyr praktikat për menaxhimin e trafikut të aksesit në internet nga ofruesit e shërbimit dhe parashikon kërkesa mbi karakteristikat teknike, kërkesat minimale për cilësinë e shërbimit dhe masa të tjera të përshtatshme dhe të nevojshme për një ose më shumë ofrues të shërbimeve të komunikimeve elektronike për publikun, përfshirë këtu edhe ofruesit e shërbimeve të aksesit në internet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet për zbatimin e tij fillojnë nga data 1 janar 2020.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 3, datë 25.10.2019

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar 'Sekret shtetëror'", i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret Shtetëror'", KDZH-ja, e ngritur me urdhrin nr. 389, datë 20.11.2017, të drejtorit të përgjithshëm të Arkivave, u mblodh me datë 25.10.2019, dhe pasi shqyrtoi relacionet e paraqitura nga sektori i ish-Arkivit Qendror të PPSH-së,

VENDOSI:

1. Deklasifikimin plotësisht të informacioneve, (dosjeve) të klasifikuara "Sekret shtetëror" si më poshtë:

- Fondi 271/AP (Këshilli i Mbrojtjes).
Viti 1963
Dosja 1, "T. Sekret".
Viti 1964
Dosja 1, "T. Sekret".
Viti 1965
Dosja 1, 2, 3, 4, 5, "T. Sekret".
Viti 1966
Dosja 2, 3, "T. Sekret".
Viti 1967
Dosja 1, 2, 4, "T. Sekret".
Viti 1968
Dosja 1, 3, 5, "T. Sekret".
Viti 1969
Dosja 1, 2, "T. Sekret".
Viti 1970
Dosja 1, 2, 3, 4, 5, "T. Sekret".
Viti 1971
Dosja 1, 3, 4, "T. Sekret", 5, "Sekret", 6, 7, 9, "T. Sekret".
Viti 1972
Dosja 1, 2, "T. Sekret" 3, "Sekret" 4, "T. Sekret".
Viti 1973
Dosja 1, 2, 3, "T. Sekret".
Viti 1974
Dosja 1, 4, "T. Sekret".
Viti 1975

Dosja 1, "Sekret", 3, 4, "Sekret", 5, "T. Sekret", 6, "Sekret", 7, 8, 10, 10/1, 11, "T. Sekret".

Viti 1976

Dosja 1, "Sekret", 2, 3, 5, 6, 7, 8, "Sekret", 9, 10, 11, "T. Sekret".

Viti 1977

Dosja 1, "T. Sekret", 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, "Sekret", 9, 10, "T. Sekret", 11, "Sekret".

Viti 1978

Dosja 1, 3, "T. Sekret", 4, "Sekret", 5, 6, 7, 8, "T. Sekret".

Viti 1979

Dosja 3, 4, 6, "T. Sekret", 7, "Sekret", 9, 10, "T. Sekret", 11, "Sekret", 14, "T. Sekret".

Viti 1980

Dosja 1, 2, 3, "Sekret", 4, 5, 7, 8, "Sekret", 10, 11, 12, 13, "T. Sekret", 14, 15, 16, "Sekret".

Viti 1981

Dosja 3, "T. Sekret", 4, "Sekret", 5, 6, "Sekret", 7, 8, "T. Sekret", 9, 10, "Sekret".

Viti 1982

Dosja 1, "Sekret", 2, "T. Sekret", 4, 5, "Sekret", 7, "T. Sekret", 8, "Sekret", 9, "T. Sekret", 10, "Sekret", 11, "T. Sekret", 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, "Sekret", 19, "T. Sekret", 20, 21, 23, 25, "Sekret", 26, "T. Sekret", 27, 28, "Sekret", 30, 31, 32, 33, "T. Sekret".

Viti 1983

Dosja 2, "T. Sekret", 3, 4, "Sekret", 5, "T. Sekret", 6, "Sekret", 7, 8, 9, 9/1, 10, 12, 14, "T. Sekret", 15, 16, 17, "Sekret", 18, "T. Sekret", 19, 20, 21, "Sekret", 22, "T. Sekret", 23, "Sekret", 24, "T. Sekret", 25, 26, "Sekret"27, "T. Sekret".

Viti 1984

Dosja 1, 2, "T. Sekret", 3, "Sekret", 4, 5, 7, 8, "T. Sekret", 9, 10, "Sekret", 11, 12, 13, 14, "T. Sekret", 15, 16, 18, 19, 20, "Sekret", 21, 22, "T. Sekret", 23, "Sekret", 25, "T. Sekret", 26, "Sekret". 27, "T. Sekret".

Viti 1985

Dosja 1, "Sekret", 2, "T. Sekret", 3, 4, "Sekret", 5, 6, 6/1, 8, 9, 10, 11, 13, 15, "T. Sekret", 16, 18, "Sekret", 19, 20, 21, 22, 23, "T. Sekret", 24, 26, 28, 28/1, "Sekret", 29, "T. Sekret".

Viti 1986

Dosja 2, 2/1, 3, 5, 6, "T. Sekret", 7, 8, "Sekret", 9, "T. Sekret", 10, 11, 12, 15, "T. Sekret" 16, 16/1, "Sekret", 17, "T. Sekret", 18, "Sekret", 19, 20, "T. Sekret", 22, 23, 24, "Sekret", 25, "T. Sekret".

Viti 1987

Dosja 2, 2/1, "Sekret", 4, 4/1, 4/2, 4/3, 4/4, 4/5, "T. Sekret", 5, "Sekret", 7, 8, "T. Sekret", 9, "Sekret", 10, "T. Sekret", 11, "Sekret", 12, 13, "T. Sekret", 14, 15, 16, 17, 18, "Sekret", 20, 22, "Sekret".

Viti 1988

Dosja 1, 1/1,1/2, 1/3,1/4, 2, 3, 4, 5, 6, "T. Sekret", 7, 8, 8/1, "Sekret", 9, 9/1,11, 12/1, 13, 14, 15, 16, 17, 18/1, 19, "T. Sekret", 20, 21, "T. Sekret".

Viti 1989

Dosja 1, 2, "Sekret", 5, "Sekret", 6, 7, "T. Sekret", 8, 9, 11, 12, "Sekret", 13 "T. Sekret", 14, 15, 16, 18, 19, "Sekret", 20, "T. Sekret", 21, 22, "Sekret".

Viti 1990

Dosja 1, "Sekret", 2, 3, 3/1, "T. Sekret", 4, "Sekret", 6, 6/1, 6/2, "T. Sekret", 7, 8, 9, 9/1, 9/2, 10, 11, 12, "T. Sekret", 12/1, 12/2, "T. Sekret", 13, 14, "Sekret", 15, "Sekret", 17, 19, 20, "Sekret".

Viti 1991

Dosja 1, 2, "Sekret", 3, 4, 6, "T. Sekret", 7, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 14/1, 15, 16, 17, "Sekret".

Dosjet deklasifikohen me arsyetimin, se publikimi i tyre është shumë më i rëndësishëm se mbajtja e tyre në nivel klasifikimi, por dhe sepse kanë humbur vlerën dhe qëllimin për të cilin janë klasifikuar, siç përcaktohet në nenin 4, pika "b" e VKM nr. 662, date 15.11 .2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"".

2. Përjashtimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" nga deklasifikimi si më poshtë:

Viti 1979, dosja 8, "T. Sekret".

Viti 1981, dosjet 1, 11, "T. Sekret".

Viti 1983, dosja 1, "T. Sekret".

Viti 1984, dosjet 6, 24 ,24/1 "T. Sekret".

Viti 1985, dosjet 12, 25, "T. Sekret".

Viti 1986, dosjet 4, 4/1, 13, "T. Sekret".

Viti 1987, dosjet 1, 3, 6, 6/1, 6/2, 19 "T. Sekret".

Viti 1988, dosjet 12, 18, 22, 22/1, 22/2, 22/3, 22/4 "T. Sekret".

Viti 1989, dosjet 3, 3/1, 4 "T. Sekret".
Viti 1990, dosja 5, "T. Sekret".
Viti 1991, dosja 5, "T. Sekret".

3. Ngarkohet sekretari i KDZH-së për zbatimin e këtij vendimi.

4. Një kopje e bibliografisë t'i dërgohet DSIK-së, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Ardit Bido

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë